Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

Maj 2015

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 310 kopje

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

1. FJALA E GUVERNATORIT 8

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË 12

2.1 Zhvillimet në inflacion 12
2.2 Inflacioni sipas kategorive 14

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE 18

3.1 Ambienti i jashtëm i ekonomisë 18
3.2 Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 23
3.3. Gjendja ciklike e ekonomisë, pagat, kostot e punës dhe prirjet e inflacionit 38
3.4 Çmimet e huaja dhe inflacioni i importuar 41
3.5 Pritjet për inflacionin 42

4. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË 43

4.1 Zhvillimet në tregjet financiare 43
4.2 Ecuria e kreditimit 49
4.3 Ecuria e treguesve monetarë 51

5. SHTOJCA STATISTIKORE 55

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1:	*Transformime të sjelljes sezonale të inflacionit: implikime për analizën dhe parashikimin*	*15*
Hapësirë informuese 2:	*Ecuria e çmimeve në tregun e banesave*	*27*
Hapësirë informuese 3:	*Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e katërt të vitit 2014*	*36*
Hapësirë informuese 4:	*Përmbledhje e rezultateve nga vrojtimi i aktivitetit kreditues*	*48*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë

Tabelë 1.	*Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)*	*15*
Tabelë 2.	*Vlerësimi i faktorëve sezonalë gjatë M2:2003-M3:2015*	*16*
Tabelë 3.	*Pesha mesatare në shportën e IÇK/HICP për dy kategoritë e ushqimeve me çmime me sezonalitet të lartë (në përqindje)*	*17*

3. Zhvillimet makroekonomike

Tabelë 4.	*Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë*	*19*
Tabelë 5.	*Tregues ekonomikë për vendet e rajonit*	*21*
Tabelë 6.	*Tregues të bilancit të pagesave*	*37*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë

Grafik 1. Inflacioni vjetor dhe objektivi (në përqindje) 12
Grafik 2. Hendeku i prodhimit dhe kontributi i inflacionit bazë 13
Grafik 3. Reagimi i normave të interesit në segmente të ndryshme ndaj uljes së normës bazë (djathtas) 14
Grafik 4. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 14
Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe të shërbimeve (në përqindje) 15
Grafik 6. Inflacionet mujore të ushqimeve sezonale për periudhën M2:2003-M3:2015 dhe mesatarja sezonale 17

3. Zhvillimet makroekonomike

Grafik 7. Ndryshimi vjetor i çmimeve bazë (në përqindje) 21
Grafik 8. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 22
Grafik 9. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 22
Grafik 10. PBB-ja dhe dinamika vjetore e komponentëve të kërkesës agregate 24
Grafik 11. Kontributet e sektorëve të ekonomisë në ecurinë e vlerës së shtuar dhe treguesit e besimit 25
Grafik 12. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim 26
Grafik 13. Indeksi i çmimit të banesave dhe indeksi i qirasë së banesave 27
Grafik 14. Raporti çmim/qira dhe tregues cilësorë nga vrojtimi i besimit të sektorit të ndërtimit 27
Grafik 15. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor 28
Grafik 16. Ecuria e vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve, dhe kontributi i saj në ekonomi 29
Grafik 17. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në shërbime dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor 30
Grafik 18. Ecuria e kërkesës së sektorit privat (vmv) dhe e treguesit të ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100) 30
Grafik 19. Tregues të tërthortë të konsumit privat 31
Grafik 20. Tregues përafrues të investimeve private 31
Grafik 21. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar 32
Grafik 22. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), ndryshimet vjetore tek zërat kryesorë të shpenzimeve (djathtas) 32
Grafik 23. Ndryshimi vjetor i të ardhurave, sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas) 33
Grafik 24. Shuma rrëshqitëse 12-mujore e deficitit (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në mld lekë (djathtas) 34
Grafik 25. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindjeje) 34
Grafik 26. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë) 35
Grafik 27. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe hendeku i prodhimit (majtas); norma e papunësisë (djathtas) 38
Grafik 28. Ecuria e pagës mesatare reale në ekonomi dhe në sektorë 39
Grafik 29. Ndryshimet vjetore mesatare të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit (majtas) 40
Grafik 30. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas) 40
Grafik 31. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas) 41
Grafik 32. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë 42

4. Zhvillimet në tregjet financiare dhe treguesit monetarë

Grafik 33. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas) 44
Grafik 34. Ecuria e yield-eve në tregun primar 44
Grafik 35. Ndryshimet vjetore të indeksit NEER, indeksi i presioneve në tregun valutor (IPV) dhe kursi bilateral i këmbimit 45
Grafik 36. Normat e interesit të kredisë së re në lekë 46

Grafik 37. Normat e interesit të kredisë së re në euro dhe ato për depozita 47
Grafik 38. Standardet dhe kërkesa për kredi e bizneseve (balanca neto) 48
Grafik 39. Standardet dhe kërkesa për kredi e individëve (balanca neto) 48
Grafik 40. Kredia për ekonominë sipas valutës dhe kredia për sektorin privat sipas agjentëve ekonomikë 49
Grafik 41. Kredia për biznese sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe sektorëve të ekonomisë (djathtas) 50
Grafik 42. Kredia për individë sipas qëllimit të përdorimit 51
Grafik 43. Treguesit monetarë 52
Grafik 44. Zhvillimet në depozita dhe norma e interesit të depozitave të reja në lekë 53

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0 për qind në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i Politikës Monetare për tremujorin e parë të vitit 2015 u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 6.5. 2015. Analiza ekonomike, financiare dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 27 prill 2015.

1. FJALA E GUVERNATORIT

Zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me pritjet tona. Rritja ekonomike u përshpejtua gjatë vitit 2014 dhe treguesit paraprakë flasin për vazhdimin e kësaj tendence edhe gjatë këtij viti. Në linjë me skenarin tonë bazë, përmirësimi i kërkesës së brendshme po reflektohet në rritje progresive të aktivitetit ekonomik dhe në një forcim gradual, por ende të brishtë, të presioneve afatgjata inflacioniste.

Goditjet e ofertës në tremujorin e parë sollën një inflacion më të lartë se pritjet tona. Këto goditje bënë të nevojshëm një rishikim të lehtë në kahun e poshtëm të rritjes së pritur ekonomike për vitin 2015. Megjithatë, efekti i tyre pritet të jetë kalimtar. Këto zhvillime nuk kanë cënuar vlerësimet tona për ecurinë në afat të mesëm të aktivitetit ekonomik dhe të inflacionit. Rritja ekonomike pritet të vijë në përmirësim gradual gjatë këtij horizonti kohor, e mbështetur në fazën fillestare nga rritja e kërkesës së brendshme. Ekonomia shqiptare parashikohet t'i afrohet nivelit potencial gjatë vitit 2016, çka do të krijojë premisat e duhura për kthimin e inflacionit në objektiv, brenda horizontit afatmesëm të veprimit të politikës monetare. Këto trajektore të pritura do të kërkojnë ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare edhe në periudhën e ardhshme.

* * *

Inflacioni vjetor rezultoi në vlerën mesatare prej 1.9% në tremujorin e parë të vitit 2015, duke qenë më i lartë se sa ai i tremujorit paraardhës dhe mbi parashikimet tona. Inflacioni bazë, i cili mat tendencat më afatgjata të ecurisë së çmimeve, vazhdoi të shënojë rritje gjatë këtij tremujori. Megjithatë, rritja e shpejtë e inflacionit në tremujorin e parë u shkaktua në pjesën më të madhe nga rritja e çmimeve të ushqimeve. Këto të fundit u shtrenjtuan përtej sjelljes së tyre sezonale gjatë kësaj periudhe. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, ky zhvillim pasqyroi reduktimin e ofertës së produkteve të freskëta ushqimore, si pasojë e përmbytjeve në muajt janar e shkurt. Si i tillë, reduktimi i ofertës së produkteve të freskëta ushqimore pritet të ketë një efekt të përkohshëm në ecurinë e çmimeve të konsumit. Nga ana tjetër, reduktimi i çmimit të naftës në tregjet botërore dha një kontribut negativ në inflacionin e këtij tremujori, ndonëse ai u balancua pjesërisht nga mbiçmimi i dollarit amerikan ndaj lekut. Çmimet e artikujve të tjerë të shportës ishin të qëndrueshme dhe me ndikim të vogël në inflacionin e përgjithshëm.

Presionet afatgjata inflacioniste nga ana e kërkesës po gjallërohen, por ato mbeten ende të përmbajtura. Ndonëse aktiviteti ekonomik vijon të përmirësohet, ekonomia ka ende kapacitete të pashfrytëzuara prodhimi. Shfrytëzimi jo i plotë i

tregut të punës dhe i kapacitetit prodhues të biznesit, mban aktivitetin ekonomik poshtë nivelit të tij potencial dhe inflacionin poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja vjetore e vlerës së shtuar rezultoi 1.9% për vitin 2014, kundrejt vlerës 1.4% të shënuar një vit më parë. Në aspektin sektorial, rritja ekonomike u mbështet nga rritja e prodhimit në sektorin e shërbimeve, në atë të bujqësisë e më pak në atë të industrisë. Nga krahu i shpenzimeve, rritja ekonomike reflektoi në masën më të madhe gjallërimin e kërkesës së brendshme private, por edhe një kontribut pozitiv të shpenzimeve publike në tremujorin e fundit. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj ka qenë e dobët dhe aktiviteti ekonomik me jashtë nuk ka dhënë impulse pozitive në rritjen ekonomike.

Në bazë të informacionit të disponuar, Banka e Shqipërisë vlerëson se ritmet pozitive të rritjes kanë vijuar edhe në tremujorin e parë të vitit 2015. Rritja ekonomike e kësaj periudhe vlerësohet të ketë pësuar një ngadalësim të përkohshëm, si pasojë e dëmeve nga përmbytjet në sektorin bujqësor e blegtoral, por edhe si pasojë e reduktimit të prodhimit të naftës, në përgjigje të konjukturës së dobët të tregut botëror.

Pavarësisht nga sa më sipër, viti 2015 parashikohet të regjistrojë një rritje ekonomike më të lartë se viti i kaluar. Rritja ekonomike pritet të mbështetet nga forcimi i konsumit dhe i investimeve private, të cilat do të ndihmohen nga kushtet monetare stimuluese dhe nga rritja e oreksit për rrezik në tregjet financiare. Gjithashtu, buxheti dhe planet fiskale të vitit 2015 parashikojnë një intensitet më të vogël konsolidimi fiskal, çka po vihet re tashmë në ecurinë e treguesve buxhetorë të tremujorit të parë. Së fundi, ekonomia shqiptare pritet të përfitojë dhe nga perspektiva më pozitive e zhvillimit të vendeve kryesore partnere tregtare. Ndonëse kjo e fundit parashikohet të jetë e pamjaftueshme për të dhënë një kontribut direkt pozitiv në rritjen ekonomike të vitit 2015, një klimë më e favorshme ekonomike e financiare në vendet partnere ndihmon besimin e agjentëve ekonomikë në vend, përmirëson kushtet e huaja të financimit dhe tenton të rritë investimet e huaja direkte. Tabloja e mësipërme pritet të ruhet edhe në vitet në vazhdim, por me një kontribut gjithnjë e më të madh të eksporteve shqiptare në rritjen ekonomike. Përmirësimet e pritura në aktivitetin ekonomik do të zbusin gradualisht hendekun negativ të prodhimit, duke ndihmuar mbylljen e tij në vitin e ardhshëm.

Informacioni i ri i disponuar dhe projeksionet e reja ekonomike nuk e ndryshojnë trajektoren e pritur afatmesme të inflacionit. Në përputhje me përmirësimin e ekonomisë, inflacioni pritet të rritet gradualisht gjatë vitit 2015 dhe në vazhdim. Inflacioni, pas katër tremujorësh, pritet të luhatet rreth një niveli mesatar prej 2.2% dhe të kthehet më tej në objektiv në afat të mesëm. Ai pritet të ndihmohet gjithashtu nga rritja e inflacionit në Eurozonë dhe nga rritja e pritjeve për inflacionin në vend.

Balanca e rreziqeve rreth parashikimit të inflacionit mbetet e zhvendosur në kahun e poshtëm. Në veçanti, rikuperimi më i ngadaltë i ekonomisë, rënia më e fortë e çmimeve në tregjet botërore dhe rënia e mëtejshme e pritjeve inflacioniste mund të çojnë në vlera më të ulëta të inflacionit.

Ecuria aktuale dhe e pritur e ekonomisë shqiptare ka kërkuar ndjekjen e një politike monetare lehtësuese. Në linjë me sinjalizimet tona për ruajtjen e normave të ulëta të interesit, Banka e Shqipërisë ka reduktuar normën bazë me 0.25 pikë përqindje në muajin janar, duke e çuar atë në nivelin 2.0%. Politika monetare lehtësuese ka synuar dhe ka arritur të ulë koston e financimit në ekonomi, në mbështetje të rritjes së kërkesës dhe të kthimit të inflacionit në objektiv. Transmetimi i saj në uljen e normave të interesave ka rezultuar i kënaqshëm, por reflektimi i saj në rritjen e kreditimit është më i ngadaltë.

Zgjerimi i kredisë është i ulët, ndonëse sistemi bankar është i mirëkapitalizuar dhe treguesit e likuiditetit dhe të përfitueshmërisë janë në nivele të kënaqshme. Ecuria e ngadaltë e kreditimit reflekton kërkesën e dobët për kredi, por dhe sjelljen konservatore të bankave. Modeli i financimit të deficitit buxhetor gjatë këtij viti pritet të sjellë lehtësimin e kushteve të financimit të sektorit privat. Zhvendosja e huamarrjes publike, nga tregu i brendshëm në atë të huaj, do të krijojë premisa për reduktim të mëtejshëm të normave të interesit dhe për rritjen e interesimit të bankave dhe të ofertës për kredi. Gjithashtu, adresimi i pritur i çështjes së kredive me probleme, nëpërmjet një platforme kombëtare gjithëpërfshirëse, do të lehtësojë bilancet e bankave dhe do të përmirësojë qasjen e tyre ndaj kreditimit. Këto zhvillime pritet të materializohen në kushte më të mira financimi gjatë vitit në vazhdim dhe në një transmetim më të mirë të stimujve të deritanishëm monetarë në rritjen e aktivitetit ekonomik. Në të ardhmen, përmirësimi i besimit dhe i gjendjes financiare në sektorin privat pritet të reflektohen në rritje të kërkesës për financim.

* * *

Banka e Shqipërisë konstaton se ecuria e ekonomisë është përgjithësisht në përputhje me pritjet. Rritja ekonomike pritet të vijë në përmirësim gradual gjatë viteve në vazhdim, çka do të krijojë premisat e duhura për kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit kohor të veprimit të politikës monetare.

Forcimi i kërkesës agregate do të jetë motori kryesor i rritjes ekonomike në afat të shkurtër e të mesëm. Në afat të gjatë, Banka e Shqipërisë thekson nevojën e thellimit të reformave strukturore, si instrumenti më i rëndësishëm për të prodhuar rritje të qëndrueshme ekonomike. Reformat strukturore duhet të synojnë rritjen e produktivitetit të ekonomisë shqiptare dhe zgjerimin e tregjeve për produktet tona. Ndër të tjera, kjo do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të një infrastrukture moderne zhvillimi, krijimit të një klime të favorshme biznesi dhe investimit të vazhdueshëm për përmirësimin e burimeve njerëzore.

Bazuar në përfundimet e analizës së prezantuar në këtë raport, Banka e Shqipërisë vlerëson se kushtet monetare aktuale janë konsistente me arritjen e objektivit për stabilitetin e çmimeve. Për të bërë të mundur përmbushjen e skenarit tonë bazë të parashikimeve ekonomike, por edhe për të adresuar balancën negative të rreziqeve, Banka e Shqipërisë gjykon se politika monetare do të vazhdojë të mbetet në kahun stimulues edhe për disa tremujorë.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Norma vjetore e inflacionit ndoqi prirje rritëse gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, duke shënuar vlerën mesatare prej 1.9%. Rritja e inflacionit ishte më e shpejtë nga sa parashikohej. Ajo u shkaktua kryesisht nga faktorë të ofertës, të lidhur me çmimet e mallrave ushqimore. Megjithatë, prirja rritëse e inflacionit reflektoi edhe forcimin e presioneve afatgjata inflacioniste, ashtu siç tregohet nga tendenca rritëse e inflacionit bazë. Projeksionet afatmesme të inflacionit sugjerojnë një rritje graduale, por progresive, gjatë tremujorëve në vijim.

Presionet e ulëta inflacioniste kërkuan forcimin e kahut stimulues të politikës monetare. Banka e Shqipërisë uli në 2.0% normën bazë të interesit në muajin janar 2015 dhe vijoi të furnizojë tregun bankar me të gjithë likuiditetin e kërkuar. Ruajtja e kushteve të lehtësuara monetare do të ndihmojë ringritjen e kërkesës dhe do të afrojë gradualisht inflacionin drejt objektivit afatmesëm.

2.1 ZHVILLIMET NË INFLACION

Inflacioni dhe objektivi

Grafik 1. Inflacioni vjetor dhe objektivi (në përqindje)*



*Deri në vitin 2014,objektivi i Bankës së Shqipërisë për inflacionin është përcaktuar në nivelin 3.0% me një interval tolerance +/-1.0%. Me rishikimin e Dokumentit të Politikës Monetare në janar 2015, ky interval u hoq duke u mbajtur një objektiv pikësor, 3%. Për më shumë, shihni "Dokumenti i Politikës Monetare".
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.9% në tremujorin e parë të vitit 2015. Ndonëse më i lartë se sa në tremujorin paraardhës, inflacioni vijoi të qëndrojë nën objektiv. Ecuria e normës së inflacionit u përcaktua kryesisht nga rritja e çmimeve të disa produkteve ushqimore të papërpunuara. Në të njëjtin tremujor, çmimi i karburanteve vijoi të jetë dukshëm më i ulët se sa i një viti më parë.

Aktiviteti ekonomik ka shënuar norma pozitive rritjeje në gjashtëmujorin e dytë të vitit të kaluar, i mbështetur kryesisht nga rritja e shpenzimeve private dhe e investimeve publike. Zbatimi i një politike monetare lehtësuese dhe stimuli fiskal i tremujorit të fundit, kanë mbështetur rritjen e kërkesës së brendshme. Rritja e përmirësuar ekonomike ka zbutur hendekun negativ të prodhimit, por nuk e ka shuar atë. Për rrjedhojë, presionet inflacioniste të gjeneruara nga krahu i kërkesës agregate vazhdojnë të mbeten të dobëta dhe nën intensitetin e tyre historik.

Krahas ndikimit të faktorëve të kërkesës, të cilët rezultuan me intensitet lehtësisht të shtuar në këtë tremujor, edhe faktorët e ofertës luajtën rol të rëndësishëm në luhatjet e inflacionit. Kushtet e pafavorshme të motit ndikuan në reduktimin e përkohshëm të ofertës së produkteve ushqimore të papërpunuara në tregun e brendshëm, si edhe në rritjen e kostove të transportit. Veprimi i këtyre faktorëve rriti më shumë dhe më shpejt nga sa pritej çmimet përkatëse, duke devijuar nga sjellja sezonale. Efekti i faktorëve të mësipërm pritet të shtrihet përgjatë vitit aktual, për t'u shuar në fillim të vitit të ardhshëm. Megjithatë, projeksionet për përmirësim të vazhdueshëm të aktivitetit ekonomik sugjerojnë se presionet mbi inflacion nga ana e kërkesës do të vijnë në rritje. Në linjë me intensitetin e përmirësimit të pritur të aktivitetit ekonomik, inflacioni parashikohet të kthehet në objektiv në afat të mesëm.

Grafik 2. Hendeku i prodhimit dhe kontributi i inflacionit bazë*



*Shënim: Seria e vlerësuar e hendekut të prodhimit, është sheshuar duke zbatuar mesataren lëvizëse me katër terma [MA(4)].
Burimi: Vlerësime të Bankës së Shqipërisë; INSTAT.

Inflacioni dhe përçimi i politikës monetare

Ambienti i përgjithshëm ekonomik, i karakterizuar nga presione të dobëta inflacioniste dhe nga rritje ekonomike nën potencial, ka diktuar ndjekjen e një politike monetare lehtësuese. Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në muajin janar, duke e çuar atë në nivelin 2.0%. Si pjesë e instrumenteve të politikës monetare, ajo vijoi të sinjalizojë verbalisht publikun për vazhdimin e një politike monetare lehtësuese edhe në tremujorët e ardhshëm. Njëkohësisht, operacionet monetare kanë konsistuar në injektime të likuiditetit me afat deri në 1-muaj për sistemin bankar. Kërkesa për likuiditet ka qenë normale dhe është reflektuar në nivele të ulëta dhe luhatje të moderuar të normave njëditore të interesit në tregun ndërbankar. Në të kundërt, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë vijuan të rriten në tremujorin e parë. Kjo lëvizje gjykohet e përkohshme, për arsye se rritja e *yield*-eve u shkaktua kryesisht nga rritja e financimit të deficitit buxhetor. Rritje të lehtë pësuan dhe interesat për kredinë në lekë në muajt janar-shkurt, në reflektim të sjelljes sezonale të kredisë dhe të aktivitetit ekonomik. Politika monetare lehtësuese dhe ulja e pritur e huamarrjes së sektorit publik në tregjet e brendshme financiare, do të shoqërohen me ulje të mëtejshme të interesit të kredisë gjatë vitit 2015.

Në përgjithësi, tendenca e normave të interesit në segmentet e tregut financiar ka qenë rënëse, duke iu përgjigjur sjelljes stimuluese të politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2011. Interesat e huamarrjes në lekë për sektorin privat janë ulur ndjeshëm, sidomos gjatë vitit 2014. Diferenca e tyre me interesat e huamarrjes në euro është ngushtuar dukshëm. Këto prirje kanë qenë më të shprehura në segmentin e bizneseve, drejt të cilëve është akorduar dhe pjesa më e madhe e kredisë në lekë. Megjithatë, zgjerimi i aktivitetit kreditues vijon të frenohet nga hezitimi i bizneseve për t'u angazhuar

Grafik 3. Reagimi i normave të interesit në segmente të ndryshme ndaj uljes së normës bazë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: Banka e Shqipërisë.

në investime afatgjata nga oreksi i ulët i sistemit bankar për të ndërmarrë rreziqe në kredidhënie.

Natyra stimuluese e politikës monetare të Bankës do të vijojë të mbështesë nxitjen e aktivitetit ekonomik, nëpërmjet lehtësimit të kushteve të financimit, duke ndihmuar njëkohësisht ankorimin e pritjeve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektivin 3.0%, brenda një periudhe afatmesme.

2.2 INFLACIONI SIPAS KATEGORIVE

Artikujt ushqimorë ishin kontribuesit kryesorë në nivelin dhe profilin e inflacionit, gjatë tremujorit të parë. Kategoria "ushqime të papërpunuara" formoi thuajse 90% të inflacionit vjetor, duke e rritur kontributin e saj me 1 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin paraardhës. Ndikimin kryesor në këtë rritje e dha shtimi me 0.9 pikë përqindjeje i kontributit të nëngrupit "perime". Pjesa më e madhe e rritjes së kontributit të kësaj kategorie erdhi për shkak të inflacionit më të lartë të saj gjatë dy muajve të parë të vitit. Veçanërisht në muajin shkurt, kur përmbytjet arritën intensitetin më të lartë, u verifikua një inflacion mujor prej 10.2% në grupin e ushqimeve të papërpunuara. [1] Kategoria "ushqime të përpunuara" kontribuoi me 0.3 pikë përqindjeje në formimin e inflacionit total vjetor. Efekti i akcizave të reja ndikoi në rritjen e çmimeve përkatëse, por në një masë më të zbutur se sa në vitin e kaluar.

Kategoritë e tjera rezultuan kryesisht me inflacion vjetor negativ dhe pakësuan me 0.1 pikë përqindje inflacionin total. Në veçanti, në kahun reduktues vijoi të veprojë kontributi i kategorisë "mallra të konsumit joushqimor" (-0.4 pikë përqindje), për shkak të rënies vjetore të çmimeve të karburanteve.[2]

Kategoria "mallra me çmime të rregulluara" kontribuoi vetëm me 0.1 pikë përqindje në formimin e inflacionit të tremujorit të parë. Në muajin mars, u reflektua në llogaritjen e IÇK-së edhe efekti i zbatimit të skemës së re të tarifimit të energjisë elektrike. Kjo skemë rezultoi të ketë ndikuar në reduktimin me rreth 0.1 pikë përqindje të inflacionit total në muajin mars. Ky reduktim pritet të mbartet në vlerën e inflacionit total gjatë vitit në vazhdim, deri në shuarjen e këtij efekti.

[1] *Rreth 5 pikë përqindje më i lartë se mesatarja e pesë viteve të fundit.*

[2] *Rënia vjetore e çmimit të karburanteve u frenua përgjatë tremujorit të parë. Kjo sepse në terma mujorë, gjatë muajve shkurt-mars 2015, inflacioni kaloi nga vlera negative në pozitive.*

Tabelë 1. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)

	T1:13	T2:13	T3:13	T4:13	T1:14	T2:14	T3:14	T4:14	T1:15
Ushqime të përpunuara (pp)	0.5	0.3	0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	0.2	0.3
Bukë dhe drithëra (pp) *	0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1	0.0
Alkool dhe duhan (pp)	0.1	0.2	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.7	2.0	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	0.8	1.7
Fruta (pp)	0.3	0.4	0.8	0.5	0.7	0.7	0.2	0.4	0.5
Perime(pp)	1.2	1.5	0.5	1.1	0.9	0.6	1.2	0.2	1.1
Shërbime (pp)	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Strehim (pp)	-0.1	-0.1	0.0	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1
Mallra konsumi joushqimor	0.0	-0.3	-0.4	-0.2	0.2	0.2	0.2	0.0	-0.4
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.1	0.1	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v %)	2.5	2.2	1.5	1.5	1.9	1.6	1.7	1.3	1.9

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe të shërbimeve (në përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: TRANSFORMIME TË SJELLJES SEZONALE TË INFLACIONIT: IMPLIKIME PËR ANALIZËN DHE PARASHIKIMIN[3]

Prania e sezonalitetit në seritë kohore të inflacionit është një fenomen i zakonshëm në ekonomitë e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Luhatjet thuajse të rregullta të çmimeve të disa mallrave dhe shërbimeve, brenda periudhave apo muajve të caktuar dhe për disa vite radhazi, krijojnë profilin sezonal të inflacionit. Disa nga faktorët që drejtojnë sjelljen sezonale në këto çmime janë: sezonaliteti në prodhimin bujqësor; sezonaliteti në kërkesën dhe në sjelljen konsumatore etj. (Kaminski et.al., 2014). Njohja e sjelljes sezonale të çmimeve ka rëndësi për politikën monetare, si në aspektin e interpretimit të saktë të informacionit të ri ashtu edhe në rritjen e saktësisë së parashikimit.

[3] *Përgatitur nga Evelina Çeliku, Departamenti i Politikës Monetare.*

Ecuria mujore e çmimeve të konsumit në Shqipëri shfaq në mënyrë të dukshme një sjellje sezonale. Në nivel më "mikro" të shportës së IÇK-së, faktorët sezonalë kanë rezultuar statistikisht të rëndësishëm veçanërisht për serinë e inflacionit të ushqimeve të papërpunuara. Megjithatë, zhvillimet në inflacion në Shqipëri, rajon dhe më gjerë, kanë treguar se intensiteti i tyre mund të ndryshojë në kohë (Sahn, 1989; Reardon, 1997; Dorward et. al. 2004). Ecuritë e inflacioneve totale dhe të grupit të ushqimeve në ekonomi të ndryshme, kanë forcuar bindjen e ekonomistëve se sjellja sezonale ka ndryshuar gjatë pesë viteve të fundit[4]. Transformimet në sezonalitet janë shkaktuar nga faktorë të tillë si: ngjarje "surprizë" të motit; përfshirjet e politikave të marketingut; diferencat në kostot e transaksioneve dhe të transportit; ndryshimet në strukturën e tregjeve dhe të integrimit të tyre; kufizimet financiare; shkalla e investimeve dhe e metodave intensifikuese në bujqësi; nënshkrimi i marrëveshjeve doganore[5]. Këto të fundit kanë ndikuar aktivitetin e import-eksporteve të prodhimeve bujqësore të freskëta dhe për rrjedhojë edhe çmimet e tyre. Për shkak të kombinimit të efekteve të disa prej faktorëve të mësipërm, në rastin e Shqipërisë, sjellja sezonale është shformuar.

Vlerësimet e mëposhtme tregojnë se ka ndryshuar intensiteti i faktorëve sezonalë sipas periudhave të caktuara: kanë ndodhur zhvendosje në kohë të sezonalitetit; në muaj të veçantë ka ndryshuar kahu i veprimit të faktorëve sezonalë.

Tabelë 2. Vlerësimi i faktorëve sezonalë gjatë M2:2003-M3:2015

Muajt	Faktorët sezonalë për 2 nënperiudha dhe për periudhën totale			
	M2:2003 - M2:2008 Nënperiudha I	M3:2008 - M3:2015 Nënperiudha II	M2:03 - M3:2015 Periudha totale	Ndryshimet statistikisht të rëndësishme në sjelljet sezonale
1	0.14	4.43	2.86	Forcim i faktorit (+) ***
2	2.77	8.18	6.02	Forcim i faktorit (+) ***
3	-0.46	0.63	0.53	Jo-sezonalitet
4	-1.24	-3.73	-2.70	Forcim i faktorit (-) (**)
5	-9.37	-8.40	-8.82	Sezonalitet i lartë dhe jo ndryshim kahu
6	-8.77	-6.66	-7.70	Sezonalitet i lartë dhe jo ndryshim kahu
7	-6.14	-5.72	-5.91	Sezonalitet i lartë dhe jo ndryshim kahu
8	-1.58	0.72	-0.05	Josezonalitet
9	1.06	2.17	1.88	Sezonalitet i lehtë dhe jo ndryshim kahu
10	-0.19	-0.18	-0.38	Josezonalitet
11	3.73	-1.66	0.43	Ndryshim i kahut ***
12	20.05	10.23	13.83	Dobësim i faktorit (+)***

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autores; (***) dhe (**) diferenca të rëndësishme statistikore për 5% dhe 10% nivel kritik, respektivisht.

Muajt që evidentojnë devijimet më të forta nga sjellja mesatare sezonale janë janari dhe shkurti, ku faktori sezonal ka rritur intensitetin në vite; dhjetorët e viteve të fundit, ku sjellja sezonale e vitit 2014 rezulton me vlerën minimale; si edhe nëntorët, ku në vitet e fundit vërehet ndryshim i kahut historik, nga pozitiv në negativ. Sezonaliteti në muajt dhjetor dhe nëntor është zbehur ndjeshëm në kohë.

Kjo sjellje evidenton një përafrim të profileve sezonale të inflacionit ndërmjet Shqipërisë dhe panelit të përzgjedhur të vendeve, kryesisht në muajt nëntor dhe dhjetor. Në të njëjtën kohë, rezulton se ndryshimet mujore të çmimeve të ushqimeve

[4] *http://www.imf.org/external/np/seminars/eng/2014/food/*
[5] *http://www.imf.org/external/np/seminars/eng/2014/food/pdf/Kaminski.pdf*

sezonale në Shqipëri, kanë ruajtur një mesatare disa herë më të lartë se sa në vendet respektive.

Grafik 6. Inflacionet mujore të ushqimeve sezonale për periudhën M2:2003-M3:2015 dhe mesatarja e sezonale



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autores; Eurostat: (HICP, 2005 = 100%) - monthly data (index) [prc_hicp_midx].

Një arsye më shumë që e thekson ndryshimin e profilit sezonal në rastin tonë, është pesha e rëndësishme që këto produkte kanë në shportën aktuale të IÇK-së[6]. Transformimeve jo shumë të mëdha të sjelljes sezonale, u përgjigjen efekte të konsiderueshme në inflacion.

Tabelë 3. Pesha mesatare në shportën e IÇK/HICP për dy kategoritë e ushqimeve me çmime me sezonalitet të lartë (në përqindje)*

Ushqime sezonale të freskëta	Mesatare 2003-2007	Mesatare 2008-2015	Ushqime të papërpunuara	Mesatare 2003-2007	Mesatare 2008-2015
BE-27	3.6	3.7	BE-27	7.3	7.3
Bullgari	6.3	4.3	Bullgari	12.1	8.9
Greqi	5.0	4.8	Greqi	8.9	8.8
Kroaci	6.1	5.4	Kroaci	13.7	11.7
Itali	4.3	4.4	Itali	8.1	8.4
Rumani	7.3	7.0	Rumani	16.5	16.1
Turqi	7.9	7.3	Turqi	12.3	11.6
Shqipëri	11.3	10.4	Shqipëri	21.9	19.3

**Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HICP).*
Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autores; Eurostat: [HICP - Item weights [prc_hicp_inë] – pesha e artikujve tek Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HICP).

Pesha mesatare e ushqimeve me sezonalitet të lartë të çmimeve është rreth 2.6-2.8 herë më e lartë në Shqipëri se sa në vendet e BE-së. Një peshë relativisht e lartë e kombinuar me ngjarje të paparashikuara në sjelljen sezonale të çmimeve, rrit pasiguritë e vendimmarrësve në interpretimin e luhatjeve të pritshme të inflacionit brenda vitit. Kjo pasiguri do të zbutej me kuptimin dhe vlerësimin më të saktë të sezonalitetit.

[6] *Shporta mbi të cilën matet IÇK-ja (dhjetor 2007).*

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Ekonomia shqiptare po rekuperohet gradualisht, në përputhje me pritjet dhe parashikimet tona. Rritja ekonomike për tremujorin e katërt të vitit 2014 rezultoi 2.4%, duke e çuar në 1.9% rritjen për gjithë vitin. Politika monetare stimuluese, zbutja e natyrës konsoliduese të politikës fiskale në pjesën e dytë të vitit dhe përmirësimi i besimit në ekonomi, mbështetën rritjen e kërkesës agregate. Në vlerësimin tonë, rritja ekonomike për vitin 2015 do të përshpejtohet, duke ruajtur në përgjithësi tendencat e vërejtura gjatë vitit 2014.

Pavarësisht rekuperimit të ekonomisë, presionet inflacioniste mbeten të dobëta dhe inflacioni qëndron poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.9% në tremujorin e parë të vitit 2015. Kthimi i inflacionit në objektiv vijon të pengohet nga faktorë të kërkesës dhe të ofertës. Së pari, në afat të gjatë, kërkesa agregate nuk po arrin të absorbojë plotësisht kapacitetet prodhuese të ekonomisë, duke i mbajtur kostot e prodhimit dhe marzhet e fitimit të ulëta. Së dyti, në afat të shkurtër, rënia e çmimeve të produkteve bazë dhe e inflacionit në tregjet partnere ka dhënë një ndikim të drejtpërdrejtë në rënien e çmimeve të mallrave të importuara e një ndikim të tërthortë nëpërmjet kostove më të ulëta për inputet e importuara nga jashtë. Së treti, pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacion të ulët kanë përforcuar presionet e dobëta inflacioniste.

Në përgjithësi, veprimi i këtyre faktorëve pritet të jetë i pranishëm edhe gjatë tremujorëve në vazhdim. Rritja e ekonomisë parashikohet të forcohet dhe kapacitetet prodhuese të ekonomisë të shfrytëzohen në mënyrë më të plotë. Në këto rrethana, inflacioni parashikohet të rritet gradualisht, duke konverguar në objektiv në afat të mesëm. Banka e Shqipërisë vlerëson se rreziqet rreth këtij parashikimi mbeten në kahun e poshtëm. Ato lidhen më së shumti me pasigurinë për zhvillimet e ardhshme ekonomike në Eurozonë, si dhe me faktorë të brendshëm ciklikë dhe strukturorë që frenojnë rritjen e qëndrueshme të kërkesës private.

Ruajtja e kahut stimulues të politikave makroekonomike është e nevojshme për kthimin e ekonomisë në ekuilibër dhe të inflacionit në objektiv.

3.1 AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

3.1.1 RRITJA EKONOMIKE DHE BALANCAT KRYESORE MAKROEKONOMIKE

Ekonomia botërore[7] ka treguar ecuri pozitive në tre muajt e parë të vitit, duke vijuar gradualisht rimëkëmbjen e saj. Dinamikat e treguesve paraprakë dhe të

[7] *Paragrafi i referohet kryesisht buletinit të fundit ekonomik të BQE-së, mars 2015 dhe analizës së treguesve PMI për PBB-në nga Markit, 7 prill 2015 (J P Morgan Global All-Industry Output Index, OECD CLI).*

tërthortë në tremujorin e parë sugjerojnë se rritja ekonomike botërore do të jetë më e shpejtë. Ajo do të mbështetet kryesisht nga rritja e pritshme në vendet e zhvilluara. Ulja e çmimit të naftës dhe e çmimit të produkteve energjetike pritet të nxisë më tej rritjen e ekonomive kryesore të zhvilluara. Rritja e normave të papunësisë në shumë nga këto vende është frenuar, krahas përmirësimeve në treguesit e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve. Presionet inflacioniste janë zbutur dukshëm, si pasojë e ecurisë rënëse të çmimeve të lëndëve të para, kryesisht atyre energjetike. Parashikimet flasin për prirje rritëse të PBB-së në vitin 2015. Megjithatë, këto parashikime rrethohen nga rreziqe, balanca e të cilave peshon më shumë për poshtë. Zhvillimet që e mbështesin këtë vlerësim lidhen me tensionet gjeopolitike në Evropën Lindore (Rusi, Ukrainë), si dhe me diferencat e ritmeve të rritjes ndërmjet shteteve dhe rajoneve.

Tabelë 4. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë	Norma e inflacionit	
	T4-14/ T3-14	T4-14/ T4-13	Shkurt-15	Mars-15/ Shkurt-15	Mars-15/ Mars-14
ShBA	1.0	2.4	5.5[1]	0.2	-0.1
Eurozonë	0.3	0.9	11.3	1.1	-0.1
Gjermani	0.7	1.5	4.8	0.5	0.1
Francë	0.1	0.2	10.6	0.7	0.0
Mbretëri e Bashkuar	0.5	2.7	5.6	0.2	0.0

Burimi: BQE, FED, Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
[1]Muaji mars 2015.

Ekonomia e Eurozonës

Rritja ekonomike në Eurozonë për tremujorin e fundit të vitit 2014, rezultoi 0.3% dhe 0.9%, përkatësisht në terma tremujorë dhe vjetorë[8]. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ekonomia e Eurozonës është forcuar. Analiza e zërave tregon vijim të rritjes së konsumit të brendshëm me një kontribut pozitiv në formimin e PBB-së. Kategoria e investimeve dhe ajo e eksporteve kanë ndikuar më pak ose kanë qenë neutrale në rritje. Në analizën sipas shteteve, spikat rritja e Gjermanisë, Spanjës dhe e Portugalisë, rritja modeste e Francës dhe tkurrja e ekonomisë italiane. Treguesit e fundit paraprijës të ecurisë së PBB-së për Eurozonën në tremujorin e parë paraqiten më të gjallëruar, duke reflektuar edhe ndikimin e "lehtësimit sasior" të filluar nga BQE-ja këtë vit[9]. Vlerësimet paraprake dhe indirekte mbi ecurinë e shitjeve, porosive të reja dhe prodhimit industrial, sugjerojnë për një rritje ekonomike më të fortë në këtë tremujor, si edhe forcimin e përgjithshëm të aktivitetit ekonomik gjatë gjithë vitit 2015. Në këtë drejtim janë shfaqur edhe treguesit e besimit të biznesit dhe konsumatorëve, të cilët paraqiten më optimistë. Normat e inflacionit mbetën të ulëta dhe në vlera të vogla negative gjatë muajve të fundit. Parashikimet e fundit[10] për Eurozonën e vendosin inflacionin në nivelin 0% për vitin 2015 dhe në rritje për vitin 2016.

---

8 *Vlerësimi i dytë për tremujorin e katërt 2014, (Eurostat, 6 mars 2015).*
9 *Vendimi u mor nga Këshilli Drejtues i BQE-së në janar 2015 dhe zbatimi filloi në mars 2015.*
10 *Parashikime të stafit të BQE-së për Eurozonën, 5 mars 2015.*

Ekonomia e ShBA-së

Ekonomia e ShBA-së vijoi rritjen edhe në tremujorin e katërt të vitit 2014, duke ndjekur prirjen pozitive të të gjithë vitit. Aktiviteti ekonomik është nxitur nga rritja e shpenzimeve konsumatore, e eksporteve, e investimeve rezidenciale dhe nga shpenzimet e qeverive vendore. Në kahun e kundërt kanë ndikuar rënia e shpenzimeve të qeverisë qendrore dhe rritja e importeve. Papunësia ka vijuar të zvogëlohet, ndërsa inflacioni vjetor në muajin mars rezultoi 0%, pas dy muajve me vlera negative. Të dhënat paraprake nga tremujori i parë sugjerojnë për rritje të shpenzimeve konsumatore, mbështetur nga të ardhurat e disponueshme më të larta, si pasojë e rënies së çmimit të naftës. Eksportet pritet të zvogëlohen, duke reflektuar mbiçmimin e dollarit kundrejt monedhave të tjera.

Ekonomitë e rajonit

Italia qëndroi në recesion ekonomik edhe në tremujorin e katërt të vitit 2014. Rënia e aktivitetit ekonomik u përcaktua nga dinamika negative e prodhimit industrial dhe atij bujqësor, ndërsa dega e shërbimeve shënoi një rritje të lehtë. Nga krahu i shpenzimeve, investimet dhe shpenzimet konsumatore vijuan ecurinë negative, ndërkohë që eksportet neto kontribuan pozitivisht. Të dhënat nga tremujori i parë i vitit janë të paqarta. Aktiviteti i rritur tregtar është shoqëruar me rritje të indekseve të besimit, por edhe me rritje të papunësisë e rënie të prodhimit industrial.

Ekonomia e Greqisë shënoi një ngadalësim të rritjes ekonomike, në tremujorin e katërt të vitit 2014. Rritja e investimeve, e shpenzimeve kapitale dhe konsumit të brendshëm, i dedikohet më së shumti efektit të bazës së ulët të krahasimit. Shpenzimet qeveritare ishin më të ulëta se i njëjti tremujor i vitit paraardhës. Situata ekonomike në tremujorin e parë pritet të jetë zhvilluar në terma të ngjashëm, nën klimën e paqartësive politike dhe negociatave të vazhdueshme të qeverisë me kreditorët e saj.

Turqia shënoi përshpejtim të ritmeve të aktivitetit ekonomik në tremujorin e katërt të vitit, si rezultat i përmirësimit të kërkesës së brendshme. Shpenzimet konsumatore dhe rritja e inventarëve kanë qenë mbështetësit kryesorë të rritjes ekonomike, ndërkohë që eksportet neto ndikuan negativisht. Investimet private dhe publike rezultuan me ritme rritjeje më të frenuara, duke ngadalësuar ecurinë ekonomike në vend. Në tremujorin e parë të vitit 2015, të dhënat nga tregtia me pakicë, eksportet neto dhe shfrytëzimi i kapaciteteve, sinjalizojnë një aktivitet ekonomik më të ngadalësuar se në tremujorin e kaluar.

Rritja ekonomike vjetore në Kosovë në tre tremujorët e parë të vitit 2014 vlerësohet[11] rreth 0.1%. Tkurrjes së konsumit të brendshëm i është përgjigjur një rritje e eksporteve neto dhe e shpenzimeve të qeverisë. Të dhënat e fundit nga tregtia e jashtme flasin për një rritje të deficitit tregtar në dy muajt e parë të vitit 2015. Numri i të papunëve rezulton të jetë rritur në tremujorin e fundit të vitit

[11] *Të dhënat e përdorura janë paraprake dhe bazohen kryesisht tek raporti periodik i Komisionit Evropian 'EU Candidate and Potential Candidate Countries' Economic Quarterly (CCEQ), prill 2015.*

2014. Normat e inflacionit kanë treguar prirje rënëse që prej muajit tetor të vitit të kaluar, duke kaluar në terren negativ në tre muajt e fundit. Inflacioni në muajin mars shënoi vlerën -0.4%, më i ulët se ai i muajit shkurt. Ritmet e rritjes së kredive dhe të depozitave në dy muajt e parë të vitit 2015 nuk kanë ndryshuar, ndërkohë që interesat mesatare të depozitave janë ulur. Interesi mesatar për kreditë nuk ka ndryshuar, duke sjellë kështu rritjen e diferencës midis këtyre dy parametrave.

Ritmi i rritjes së aktivitetit ekonomik në Maqedoni është ngadalësuar në tremujorin e katërt, pas tre tremujorësh rritjeje të shpejtë. Kjo ecuri ka pasqyruar frenimin e investimeve. Efekti pozitiv nga rritja e eksporteve është shuar pjesërisht nga përshpejtimi i importeve. Zhvillimi ekonomik është mbështetur tek prodhimi industrial dhe tek aktiviteti i sektorit të ndërtimit. Të dhënat për muajt e parë të vitit 2015 sugjerojnë një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë.

Tabelë 5. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së T4:14/T4:13	Inflacioni vjetor Mars-14	Norma e papunësisë Shkurt -14
Itali	-0.5	0.0	12.7
Greqi	1.3	-1.9	26.1[1]
IRJM	2.7	-0.3	27.6[1]
Serbi	-1.8	1.9	16.8[1]
Kroaci	0.4	0.0	18.5
Turqi	2.6	7.6	11.3[3]
Kosovë	1.4[2]	-0.4	30.0[4]
Shqipëri	2.4	2.2	18.0[1]

[1] Vlera për T4 2014; [2] Vlera për T3 2014; [3] Vlera për muajin janar 2015; [4] Vlera për vitin 2013

3.1.2 ÇMIMET E LËNDËVE TË PARA DHE TË PRODUKTEVE BAZË

Çmimet e mallrave kryesore kanë shënuar rënie të konsiderueshme vjetore gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Sipas indeksit evropian Brent, çmimi i naftës u përgjysmua, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Një fuçi nafte u tregtua mesatarisht me 54 dollarë/fuçi ose 30% më lirë se në tremujorin e kaluar. Kjo ecuri i detyrohet kryesisht ritmeve të ulëta të rritjes së kërkesës, kundrejt rritjes konstante të prodhimit. Gjatë këtij tremujori, rënia e çmimit të naftës, si dhe forcimi i dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare, kanë shtuar presionet për poshtë në çmimet e mallrave të tregtuara në dollarë.

Çmimet e mallrave kryesore ranë me 35.4% në terma vjetorë dhe me 19.1% në ata tremujorë. Në këtë linjë, qëndroi edhe indeksi i çmimeve të ushqimeve, i cili në fund të periudhës u tkurr me 23.0% në terma

Grafik 7. Ndryshimi vjetor i çmimeve bazë (në përqindje)



Burimi: FMN, EIA.

vjetorë. Ritmet e larta të rritjes së ofertës kundrejt një dinamike të dobët të kërkesës, kanë qenë faktorët përcaktues të këtyre zhvillimeve.

Çmimet e naftës pritet të luhaten pranë vlerave 55 dhe 63.5 usd/fuçi, përkatësisht në pjesën e parë dhe të dytë të vitit[12], dhe me rritje përgjatë vitit 2016 (75 usd/fuçi). Ndërkohë, çmimet mesatare të mallrave kryesore priten të ndjekin një trajektore në rënie, deri në tremujorin e tretë të vitit, dhe me një rritje sezonale në fund të tij[13].

3.1.3 POLITIKA MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT

Grafik 8. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed,BoJ dhe BoE)

Bankat qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit: BQE-ja në 0.05%; Rezerva Federale në 0.15%; Banka e Anglisë në 0.5%; Banka e Japonisë në 0-0.1%.

Normat euribor në tregjet e parasë të Eurozonës janë zvogëluar më tej këtë tremujor, ndërsa ato për dollarin amerikan (libor) kanë ruajtur të njëjtin nivel. Politika lehtësuese e likuiditetit nga ana e BQE-së është faktori kryesor ndikues në këtë sjellje. Norma ditore eonia e tregut ndërbankar në euro, luhatet në territor negativ që prej muajit dhjetor të vitit 2014.

Në tregjet e kapitaleve në Eurozonë, *yield*-et e obligacioneve kanë reflektuar efektet e fillimit të programit të lehtësimit sasior nga BQE-ja, duke regjistruar ulje të mëtejshme. Kjo prirje është reflektuar edhe tek *yield*-et e titujve të emetuar nga korporatat, duke ndikuar në uljen e kostos së financimit të tyre.

Grafik 9. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters.

[12] *Sipas U.S Energy Information Agency (EIA). Të dhënat i referohen raportit mujor, prill 2015.*
[13] *Sipas vlerësimeve të FMN-së (prill 2015).*

Gjithsesi, *yield*-et e obligacioneve të shteteve me detyra konsolidimi fiskal (Itali, Portugali, Spanjë) janë influencuar nga pasiguritë e lidhura me zgjidhjen e ngërçit të Greqisë. Këto *yield*-e janë shfaqur të luhatshme, ndërsa në muajin mars të këtij viti ulja e tyre është frenuar. Në tregjet valutore, euroja është nënçmuar në terma tremujorë ndaj: dollarit amerikan (9.9%); renminbit kinez (8.6%); paundit britanik (5.8%) dhe jenit japonez (6.0%). Në terma mesatarë bilateralë, në muajin mars, një euro u këmbye me 1.084 dollarë amerikanë, duke u nënçmuar 4.5% krahasuar me një muaj më parë dhe 21.6% krahasuar me vitin e kaluar.

3.2 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Ekonomia shqiptare u rrit me 2.4% në tremujorin e katërt të vitit 2014, e mbështetur kryesisht nga investimet publike dhe e reflektuar në zgjerimin e aktivitetit të sektorit të shërbimeve dhe të atij të ndërtimit. Nga ana tjetër, kërkesa private u ngadalësua dhe kërkesa e huaj reduktoi rritjen e ekonomisë në këtë tremujor.

Në përgjithësi, informacioni i ri ekonomik ka ulur vlerësimet tona për rritjen e ekonomisë në vitin 2015. Dëmtimi i sektorit të bujqësisë nga përmbytjet në zonat jugore të vendit, si dhe problemet në sektorin e naftës, pritet të faktorizohen në një rritje më të ulët të ekonomisë në tremujorin e parë. Megjithatë, ndikimi i këtyre goditjeve pritet të jetë i përkohshëm dhe të kompensohet në vijim nga forcimi i kërkesës private, përmirësimi i kushteve të financimit dhe nga përmirësimet e pritura të ekonomive në vendet partnere. Rritja ekonomike për vitin 2015 parashikohet të jetë më e lartë se ajo e vitit të kaluar, ndonëse balanca e rreziqeve mbetet e zhvendosur në kahun rënës.

Në linjë me vlerësimet tona të mëparshme, rritja ekonomike dhe aktiviteti ekonomik për vitin 2014 rezultuan të përmirësuar, duke regjistruar një normë vjetore rritjeje prej 1.9%. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik nuk ishte i njëtrajtshëm nëpër tremujorë, i ndikuar nga faktorë të përkohshëm dhe efekte statistikore të bazës së krahasimit[14]. Pas tkurrjes me 0.2% në tremujorin e dytë të vitit, vlera e shtuar në ekonomi u rrit me 3.9% dhe 2.4%[15], përkatësisht në tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit. Pavarësisht këtyre luhatjeve, ekonomia qëndroi në një prirje të qartë rritëse në pjesën e dytë të vitit.[16]

Kushtet monetare stimuluese, rritja e besimit të agjentëve ekonomikë, si dhe përmirësimi i likuiditetit të sektorit privat, kanë nxitur kërkesën e brendshme. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj ka rezultuar e dobët. Tremujori i katërt i vitit u karakterizua nga një konsum privat më i pakët dhe kontribut më i lartë i sektorit publik në rritjen

[14] *Analiza e këtyre faktorëve është trajtuar në raportet e politikës monetare për tremujorët e mëparshëm.*

[15] *Publikimi i llogarive kombëtare për vitin 2013 ka sjellë rishikime të serisë tremujore të vlerës së shtuar për ekonominë.*

[16] *Normat tremujore të rritjes kanë qenë në rritje progresive, me rreth 0.8 dhe 1.1%, në këtë periudhë.*

ekonomike. Pagimi i faturave të prapambetura të energjisë elektrike dhe zbehja e besimit konsumator ndikuan sjelljen konsumatore në këtë periudhë. Nga ana tjetër, investimet e larta në infrastrukturë kanë shtuar kontributin e sektorit publik dhe atij ndërtues në rritjen e ekonomisë në fund të vitit.

Grafik 10. PBB-ja dhe dinamika vjetore e komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e parë të vitit 2015 tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes, por me një ritëm më të ulët se në tremujorin paraardhës.[17] Dëmet nga përmbytjet në sektorin bujqësor e blegtoral, si dhe dobësia e sektorit të naftës, vlerësohet të ngadalësojnë ritmet e rritjes. Nga ana tjetër, shpenzimet e sektorit privat pritet të përfitojnë nga normat e ulëta të interesit e të inflacionit, rritja e punësimit, si dhe nga vijimi i pagesave të detyrimeve të prapambetura të qeverisë. Politika fiskale pritet të ndjekë trajektoren e planifikuar konsoliduese, duke pasur hapësira të pakta për zgjerim të kontributit të sektorit publik në rritje ekonomike. Nga ana tjetër, një politikë e tillë i shërben reduktimit të primeve të rrezikut dhe rrit hapësirat për financimin e sektorit privat.

Besimi i agjentëve ekonomikë qëndron në nivelet e tij të parakrizës, duke dështuar për një moment pozitiv në ekonomi. Së bashku me përmirësimin e besimit dhe të oreksit për rrezik në ekonomi, kushtet monetare stimuluese do të ndihmojnë në forcimin e vazhduar të konsumit dhe investimeve private. Kërkesa e huaj parashikohet të rrisë kontributin e saj, në linjë me përmirësimin e ekonomive të vendeve partnere. Ekonomia parashikohet të rritet progresivisht gjatë viteve në vazhdim, por balanca e rreziqeve ndaj këtij parashikimi mbetet në kahun rënës. Rritja e ekonomisë do të vijojë të kushtëzohet nga kapacitetet e lira në tregjet e kapitalit dhe të punës, nga rekuperimi i oreksit për rrezik në tregjet financiare dhe nga nevoja për rregullim të bilanceve në sektorë të veçantë të ekonomisë.

[17] *Analiza ekonomike dhe vlerësimet e kërkesës agregate për tremujorin e parë janë mbështetur mbi treguesit e përditësuar fiskalë, të tregtisë së jashtme, të kredisë dhe të depozitave deri në muajin shkurt 2015 dhe të treguesve të besimit për tremujorin e parë të vitit 2015.*

3.2.1 PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[18]

Ndonëse në një masë më të ulët, rritja e vlerës së shtuar në ekonomi gjatë tremujorit të katërt 2014, vijoi të mbështetet kryesisht nga sektori i shërbimeve. Sektori i shërbimeve kontribuoi me 1.3 pikë përqindje në rritjen totale të ekonomisë në këtë periudhë.[19] Sektori prodhues u ngadalësua dhe pakësoi masën e kontributit në rritjen ekonomike - nga 1.9 në 1.1 pikë përqindje – gjatë tremujorit të fundit. Kjo pasqyroi tkurrjen e prodhimit bujqësor dhe ngadalësimin e aktivitetit industrial, në një kohë që ndërtimi ishte dega e ekonomisë që kontribuoi në masën më të madhe në rritjen vjetore të vlerës së shtuar.

Grafik 11. Kontributet e sektorëve të ekonomisë në ecurinë e vlerës së shtuar dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesi i ndjesisë ekonomike shënoi rënie me 4.6 pikë në tremujorin e parë të vitit 2015. Kjo ecuri e treguesit sugjeron për moderim të ritmit të zgjerimit të aktivitetit ekonomik në këtë periudhë. Megjithatë, niveli i besimit qëndron pranë mesatares historike afatgjatë.

Ecuria pozitive e sektorit të ndërtimit ndikoi në zgjerimin e vlerës së shtuar në ekonomi me 1.6 pikë përqindje në tremujorin e katërt. Vlera e shtuar nga aktiviteti ndërtues u zgjerua me 10.8% në këtë tremujor, duke vijuar ritmin pozitiv (9.0%) të tremujorit të tretë. Dinamika pozitive e vlerës së shtuar të sektorit në pjesën e dytë të vitit, është e lidhur me: miratimin e një numri të

[18] *INSTAT-i i publikoi të dhënat e vlerës së shtuar bruto reale, sipas aktiviteteve ekonomike për tremujorin e katërt të vitit 2014, në datën 3 prill të vitit 2015. Meqenëse INSTAT-i nuk bën vlerësime tremujore të taksave dhe subvencioneve mbi produktet në terma realë, ecuria e prodhimit sipas sektorëve nëpër tremujorë analizohet vetëm për vlerën e shtuar bruto dhe jo në terma të prodhimit të brendshëm bruto. Të dhënat e publikuara janë rishikuar në një masë më të madhe për vitin 2014. Më konkretisht, në publikimin e muajit prill, rritja vjetore e vlerës së shtuar në tre tremujorët e parë ishte përkatësisht 1.6%, -0.2% dhe 3.9%. Ndërkohë, në publikimin e mëparshëm këto norma ishin respektivisht 1.4%, -0.4% dhe 3.3%. Duhet theksuar se rishikimi i të dhënave është një proces periodik i lidhur me pasurimin dhe përditësimin e informacionit.*

[19] *Kundrejt 2.0 pikë përqindje në tremujorin e kaluar.*

madh lejesh ndërtimi, kryesisht në tremujorin e tretë[20]; përmirësimin e likuiditetit të sektorit, si pasojë e pagesës së detyrimeve të prapambetura nga qeveria[21]; dhe shtimin e ndërtimeve infrastrukturore në transport.[22]

Grafik 12. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në tremujorin e parë të vitit 2015, vlerësohet më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke sugjeruar se zhvillimet në ndërtim do të mbeten pozitive, por me ritme vjetore më të ulëta se ato të tremujorit paraardhës. Vijimi i projekteve të investimeve publike pritet të ndikojë pozitivisht ecurinë e sektorit të ndërtimit përgjatë gjysmës së parë të vitit 2015.[23]

[20] *Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara ishte 58, 39, 122 dhe 51, gjatë katër tremujorëve të vitit 2014. Treguesi mbetet nën mesataren e numrit të lejeve të akorduara në kohë. Të dhënat e lejeve të ndërtimit dhe llojeve të ndërtimeve publikohen në buletinet statistikore tremujore të INSTAT-it.*

[21] *Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj bizneseve të angazhuara në kryerjen e investimeve publike në infrastrukturë (ndërtime dhe riparime rrugësh, shkollash etj.) vijoi edhe gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2014. Si rezultat, gjykohet se pagesat e detyrimeve kanë luajtur rol pozitiv për aktivitetin ndërtues në tremujorin e katërt.*

[22] *Të dhënat e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit shënuan rritjen më të lartë, krahasuar me një vit më parë, për punimet inxhinierike kryesisht në fushën e transportit, si rrugë dhe autostrada. Në tremujorin e fundit, vlerësohet me rritje edhe realizimi i punimeve të tjera inxhinierike si linjat e ujësjellësve, ato elektrike dhe ato të telekomunikacionit, ndërtime komplekse në kantieret industriale dhe punime të tjera. Kontribut pozitiv në realizimin e projekteve infrastrukturore ka dhënë edhe Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, me financimin e projekteve të lidhura me përmirësimin e rrugëve dhe fasadave.*

[23] *Duke iu referuar vendimit të KZhR-së, nr. 14, datë 23.09.2014, "Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve" dhe shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve", si edhe Relacionit mbi Projektligjin "Për buxhetin e vitit 2015", tetor 2014.*

*HAPËSIRË INFORMUESE 2: ECURIA E ÇMIMEVE NË TREGUN E BANESAVE**

Indeksi i çmimit të banesave dhe indeksi i qirasë ranë përkatësisht me 3.7% dhe 6.3% në terma realë, në tremujorin e parë të vitit 2015. Pavarësisht luhatjeve afatshkurtra, prirja e të dy indekseve ka qenë rënëse gjatë viteve të fundit, e ndikuar nga kërkesa e dobët konsumatore. Niveli aktual i indeksit të çmimeve është 20.6% më i ulët se në vitin 2010, ndërsa indeksi i qirasë 16.2%.

*Lidhja historike e dy indekseve është e përmbledhur në raportin çmim/qira. Dinamika e ngjashme e çmimit dhe e qirasë së banesave gjatë viteve të fundit është përkthyer në një raport pothuaj konstant të indekseve përkatëse**. Vlera e këtij raporti qëndron në të njëjtin nivel me atë të një viti më parë.*

Grafik 13. Indeksi i çmimit të banesave dhe indeksi i qirasë së banesave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i banesave është karakterizuar si nga gjallërimi i kërkesës konsumatorë, ashtu edhe nga ai i ofertës gjatë vitit të kaluar.

Bazuar në të dhëna nga vrojtimi i besimit të këtij sektori, megjithë rritjen e kërkesës në sektorin e ndërtimit dhe pakësimit gradual të inventarëve, bizneset kanë qenë të

Grafik 14. Raporti çmim/qira dhe tregues cilësorë nga vrojtimi i besimit të sektorit të ndërtimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*përmbajtura në rritjen e çmimit të prodhimit. Kjo është reflektuar pjesërisht dhe në rënien e çmimeve përfundimtare të shitjes së banesave, matur nëpërmjet indeksit të çmimit të banesave***.*

* *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacionin mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*
** *Raporti i indeksit të çmimeve ndaj atij të qirasë është një tregues që përdoret si sinjalizues paraprak i mbinxehjes së tregut të çmimeve të banesave.*
*** *Çmimet e prodhimit të marra nga vrojtimi i besimit përfaqësojnë të gjithë sektorin ndërtues (ndërtesa për banime dhe për qëllime të tjera dhe punime inxhinierike), ndërsa indeksi i çmimit të banesave, i matur nga BSH-ja, mat çmimin final të shitjes së apartamenteve.*

Sektori i industrisë vijoi të shfaqë dinamikë të ngadaltë rritjeje në tremujorin e katërt të vitit 2014. Pas rritjes vjetore me 3.4% në tremujorin e tretë, vlera e shtuar nga aktiviteti industrial u rrit me 1.6% në tremujorin në analizë. Ky sektor llogaritet të ketë kontribuar me 0.2 pikë përqindje në rritjen vjetore të vlerës së shtuar në ekonomi.

Grafik 15. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në një analizë më të detajuar brenda sektorit, dega e industrisë përpunuese ndikoi pozitivisht me 1.8 pikë përqindje në rritjen e prodhimit industrial, e ndikuar në masën më të madhe nga përmirësimi i zhvillimeve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike[24]. Në të kundërt, vlera e shtuar në industrinë nxjerrëse regjistroi rënie vjetore me 0.5% në tremujorin e katërt, duke e ulur prodhimin industrial me 0.2 pikë përqindje. Kjo pasqyroi kryesisht rënien në nëndegën "Nxjerrja e mineraleve energjitike". Përkeqësimi

[24] *Vlera e shtuar nga prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike kontribuoi pozitivisht me 0.2 pikë përqindje në rritjen vjetore të aktivitetit ekonomik, pas ndikimit negativ, mesatarisht me 0.6 pikë përqindje, për 5 tremujorë radhazi.*

i ecurisë së treguesve të vrojtimeve për industrinë në tremujorin e parë të vitit 2015, e shtyn më tej në kohë gjallërimin potencial të sektorit[25].

Vlera e shtuar nga aktivitetet e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve, shënoi tkurrje vjetore me 2.7% në tremujorin e katërt të vitit 2014, kundrejt rritjes vjetore të tremujorit të kaluar (2.0%). Kontributi i këtyre aktiviteteve për ekonominë llogaritet negativ, në masën 0.7 pikë përqindje, për tremujorin në analizë. Megjithëse, për vitin 2014, prodhimi bujqësor shfaqi ecuri më të mirë se rritja e vitit 2013, ai mbetet nën normën mesatare të rritjes 6.2%, për periudhën 2010 – 2012. Dëmtimi i pjesshëm i prodhimit bujqësor vlerësohet të materializohet si një goditje me ndikim negativ në performancën e sektorit të bujqësisë në tremujorin e parë të vitit 2015.

Grafik 16. Ecuria e vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve, dhe kontributi i saj në ekonomi



Burimi: INSTAT.

Sektori i shërbimeve vazhdoi të gjenerojë rritje vjetore të vlerës së shtuar nga aktivitetet e përfshira në të me 2.5%, në tremujorin e fundit të vitit 2014. Kjo normë rritjeje rezultoi më e ulët krahasuar me zgjerimin vjetor 3.8% të shënuar një tremujor më parë, por mbetet mbi normën mesatare të rritjes vjetore prej 2.2%. Zhvillimet pozitive pasqyruan rritjen e vlerës së shtuar nga shërbimet e tjera[26] dhe nga tregtia, të cilët kontribuan me përkatësisht 1.0 dhe 0.5 pikë përqindje në rritjen e ekonomisë. Megjithatë, si shërbimet e tjera, ashtu edhe aktiviteti tregtar, rezultuan më të ngadalësuara në fundin e vitit[27].

Brenda sektorit të shërbimeve, rënia vjetore e vlerës së shtuar në degën e postës dhe të komunikacionit uli rritjen e vlerës së shtuar në ekonomi me 0.3 pikë përqindjeje[28]. Ndërkohë, efekti negativ i goditjes në aktivitetin e transportit ajror[29] një vit më parë, është shuar thuajse plotësisht në tremujorin e katërt të vitit 2014. Dega e transportit regjistroi një rritje të lehtë me 3.0%, duke dhënë një kontribut të vogël (0.1 pikë përqindje) në rritjen totale vjetore të vlerës së shtuar. Rënia në treguesit e vrojtimit të besimit në këtë aktivitet, sinjalizon ngadalësim të tij në tremujorin e parë të vitit 2015.

[25] *Duhet theksuar se dega e prodhimit dhe e shpërndarjes së energjisë elektrike vlerësohet të vazhdojë të ndikojë pozitivisht për rritjen e aktivitetit, si në periudhën afatshkurtër - si rezultat i rreshjeve të dendura të shiut në tremujorin e parë - ashtu edhe në afatgjatë - si pasojë e reformimit strukturor të sektorit - në reflektim të rritjes së eficiencës në funksionimin dhe administrimin e sistemit (për shembull, Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 02.02.2015, "Mbi miratimin e marrëveshjes midis KESH sh.a. dhe OST për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit për vitin 2015", e publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 21).*

[26] *Ecuria pozitive e kësaj dege u përcaktua në masën më të madhe nga shërbimet e tjera kolektive, sociale dhe personale.*

[27] *Rënia vjetore e vlerës së shtuar nga shërbimet në fushën e arsimit ndikoi ndjeshëm ngadalësimin e shërbimeve të tjera, ndërsa në aktivitetet tregtare, tregtia me pakicë u rrit me ritme më të ulëta në tremujorin e katërt.*

[28] *Të dhënat e shifrës së afarizmit në vëllim dëshmojnë se dinamika negative u përcaktua nga ecuria e nëndegës së komunikacionit.*

[29] *Dalja nga tregu e kompanisë shqiptare të fluturimit Bell Air në tremujorin e katërt të vitit 2013.*

Grafik 17. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në shërbime dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

3.2.2 KËRKESA AGREGATE

Kërkesa agregate shënoi rritje në tremujorin e katërt të vitit 2014, e mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Kërkesa e brendshme u mbështet nga rritja e besimit në ekonomi, normat e ulëta të interesit, rritja e punësimit, kushtet monetare lehtësuese dhe rritja e investimeve publike. Kërkesa e huaj rezultoi e dobët dhe rritja e importeve përcaktoi kontributin negativ të eksporteve neto.

Vlerësimet tona tregojnë se kërkesa e brendshme ka mbështetur rritjen ekonomike edhe në tremujorin e parë të vitit 2015, ndërsa kontributi i kërkesës së huaj ka mbetur negativ. Të dhëna paraprake sasiore dhe indirekte sugjerojnë se investimet ishin kontribuesi kryesor në rritjen e kërkesës së brendshme private, ndërkohë që kontributi nga konsumi familjar ka qenë i ulët. Tregues nga vrojtimet e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve konfirmojnë këto zhvillime.

Konsumi privat u ngadalësua në tremujorin e katërt të vitit, pas rritjes progresive në tre tremujorët e parë. Treguesi i tregtisë me pakicë ngadalësoi ritmin e rritjes në 4.1% në tremujorin e katërt, pas rritjes mesatare prej 5.4% të nëntëmujorit të parë të vitit. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të faturave të energjisë elektrike dhe rënia e besimit theksuan sjelljen hezituese të konsumatorëve për të kryer shpenzime në këtë periudhë. Kjo u reflektua në masë më të madhe në uljen e konsumit të shërbimeve dhe të blerjeve të mëdha. Nga ana tjetër, përmirësimi i treguesve të punësimit, rritja e remitancave dhe e kredisë konsumatore, kanë mbështetur kërkesën konsumatore.

Grafik 18. Ecuria e kërkesës së sektorit privat (vmv) dhe i treguesit të ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesit e besimit sinjalizojnë për konsum të ulët edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Treguesi i besimit në bizneset e degës së tregtisë u ul me 4 pikë përqindje, ndërsa treguesi i besimit konsumator ra nën mesataren afatgjatë në këtë periudhë. Por, nga ana tjetër, informacioni sasior i disponuar nga importi i mallrave për qëllime konsumi dhe kredia për individë është pozitiv.

Grafik 19. Tregues të tërthortë të konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Investimet private u rritën në tremujorin e katërt të vitit 2014, të ndihmuara nga një klimë besimi e përmirësuar në këtë periudhë dhe nga flukset pozitive të investimeve të huaja direkte. Rritja e kredisë për investime, norma më e lartë e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, si dhe përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve në tremujorin e katërt, nxitën rritjen e investimeve në këtë periudhë.

Rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve gjatë dy muajve të parë, sugjeron për kontribut pozitiv të këtij komponenti edhe për tremujorin e parë të vitit 2015.

Grafik 20. Tregues përafrues të investimeve private



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Megjithëse bizneset raportuan në përgjithësi një normë shfrytëzimi kapacitetesh më të ulët se një tremujor më parë, balanca e investimeve u rrit në këtë tremujor, veçanërisht në sektorin e shërbimeve[30].

Treguesit fiskalë dhe politika fiskale

Politika fiskale ka pasur natyrë stimuluese në tremujorin e parë të vitit 2015, si edhe në tremujorin e mëparshëm. Ky zhvillim është përcaktuar nga rritja e shpenzimeve, efekti i të cilave ka tejkaluar rritjen e të ardhurave. Megjithatë, kjo sjellje ndikohet nga efekte të bazës së ulët krahasuese dhe pagimi i detyrimeve të prapambetura nga ana e qeverisë.

Grafik 21. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar*



Δ Deficiti primar përjashtuar detyrimet e prapambetura (PD/GDPt-PD/GDPt-1)

*Stimuli fiskal është përafruar nga ndryshimet e raporteve të deficitit primar, për një periudhë 12-mujore ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Çdo vlerë në grafik reflekton ndryshimin për 12 muajt e fundit kalendarikë, krahasuar me 12-mujorin e mëparshëm. Ndryshimet pozitive në këto raporte tregojnë stimul pozitiv fiskal, ndërkohë që diferencat negative sinjalizojnë konsolidim fiskal.

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shpenzimet buxhetore kanë shënuar një rritje vjetore në tre muajt e parë të vitit, kryesisht si pasojë e pagimit të detyrimeve të prapambetura. Efekti i tyre është përforcuar nga rritja e shpejtë e shpenzimeve kapitale[31]. Shpenzimet në tremujorin e parë të vitit kanë rezultuar 90.5 miliardë lekë, duke qenë rreth 5.9% më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente, që përbëjnë pjesën kryesore të shpenzimeve publike, janë tkurrur me rreth 2.8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan një rritje vjetore prej 11.9%. Këto të fundit, kontribuan me rreth 1 pikë përqindje në rritjen vjetore të shpenzimeve totale. Detyrimet e prapambetura të paguara për periudhën tremujore kanë arritur në rreth 7.4 miliardë lekë dhe janë realizuar në masën 78% të sasisë së planifikuar për këtë periudhë. Nëse përjashtojmë shlyerjen e

Grafik 22. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), ndryshimet vjetore tek zërat kryesorë të shpenzimeve (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

[30] *Bazuar në rezultatet e vrojtimit të besimit të bizneseve.*

[31] *Kjo pjesë e vitit reflekton gjithashtu dhe efekt statistikor të bazës së ulët krahasuese.*

këtyre detyrimeve, shpenzimet buxhetore në tremujorin e parë të vitit do të rezultonin në 83 miliardë lekë ose 1.5% më të ulëta se një vit më parë[32].

Të ardhurat buxhetore kanë rezultuar rreth 86.6.7 miliardë lekë në tremujorin e parë të vitit ose 3.6% më të larta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Plani i të ardhurave totale për këtë periudhë është realizuar thuajse plotësisht.[33] Në tre muajt e parë të vitit, të ardhurat tatimore kanë treguar një tkurrje prej 1.3% krahasuar me një vit më parë. Kjo ecuri ka pasqyruar rënien e të ardhurave nga "Tatimi mbi vlerën e shtuar", të cilat përbëjnë pjesën kryesore të këtij zëri. Këto të fundit u tkurrën me 9% në terma vjetorë. Rritje të shpejtë kanë treguar të ardhurat nga "Tatimi mbi fitimin" dhe nga "Akcizat", të cilat kanë shënuar rritje vjetore me rreth 37.6% dhe 19.1%[34] përkatësisht. Të ardhurat nga "Tatimi mbi të ardhurat personale" ranë me rreth 5% në terma vjetorë. Kontribut tjetër pozitiv kanë dhënë të ardhurat "Jotatimore"[35] dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, të cilat janë rritur me 12.4% në terma vjetorë[36].

Grafik 23. Ndryshimi vjetor i të ardhurave sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

[32] *Deri në muajin mars, rreth 64% e shlyerjeve konsiston në detyrime të prapambetura në infrastrukturë.*

[33] *Për periudhën janar-mars 2015, të ardhurat totale janë realizuar në masën 98.1% të sasisë së planifikuar në buxhetin e vitit 2015.*

[34] *Të ardhurat nga akcizat pasqyrojnë efektin bazë të një viti më parë. Në vitin 2014 filloi aplikimi i tarifave të rritura për mallrat e importit nga akciza. Duke qenë se bizneset i kishin paraprirë këtij fenomeni në fund të vitit 2013, të ardhurat nga akciza për tremujorin e parë të vitit 2014 kanë qenë në nivele të ulëta.*

[35] *Të ardhurat jotatimore kanë pasqyruar rritjen e shpejtë të të ardhurave nga institucionet buxhetore, që janë rritur me rreth 138.1%, krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar.*

[36] *Me datë 1 janar hyri në fuqi udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", nëpërmjet të cilit u vendos rritja e pagës minimale mbi të cilën llogariten detyrimet për të deklaruarit si të vetëpunësuar dhe për punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin. Kjo rritje ka sjellë edhe rritjen e të ardhurave nga kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.*

Deficiti buxhetor në tremujorin e parë të vitit arriti në 3.9 miliardë lekë, duke qenë rreth 115.1% më i lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky zhvillim mbart jo vetëm efektin e bazës së ulët krahasuese, por edhe natyrën mjaft të luhatshme të këtij treguesi në muajt e parë të vitit. Financimi i këtij deficiti është arritur nëpërmjet burimeve të jashtme, kryesisht nga huaja e disbursuar nga FMN-ja. Krahas burimeve të huaja, është rritur edhe kërkesa e qeverisë për financim në tregun e brendshëm. Nga ana tjetër, gjendja e llogarive të qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë është rritur, duke ilustruar faktin se huamarrja bruto e qeverisë ka qenë më e lartë se nevojat e saj për financimin e deficitit.

Grafik 24. Shuma rrëshqitëse 12-mujore e deficitit (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në mld lekë (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit.

Kërkesa e huaj dhe tregtia e jashtme

Deficiti real tregtar në mallra dhe në shërbime vijoi të zgjerohet edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014. Ai shënoi një zgjerim vjetor prej rreth 4.2% gjatë këtij tremujori, ndërkohë që zgjerimi i deficitit tregtar për vitin 2014 qëndroi në nivelin 7.8%. Ecuria e tremujorit në analizë vlerësohet të ketë dhënë një kontribut negativ prej 1.0 pikë përqindjeje në ndryshimin vjetor të kërkesës agregate. Ndikim të qenësishëm dha rënia vjetore e eksportit real të mallrave. Për të gjithë vitin 2014, vlerësimet tona tregojnë një kontribut negativ të eksporteve reale neto në rritjen ekonomike me rreth 1.7 pikë përqindjeje. Projeksionet tona për vitin 2015 sinjalizojnë vijimin e kontributit negativ të sektorit të jashtëm në rritjen e kërkesës agregate, në masë të përafërt me atë të vitit të kaluar.

Grafik 25. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Të dhënat më të fundit mbi ecurinë e eksporteve neto për tremujorin e parë të vitit 2015, përfshijnë vetëm komponentin e tregtisë në mallra për periudhën janar-shkurt. Deficiti tregtar në mallra për këto dy muaj u zgjerua me rreth 6.9% në terma vjetorë. Përcaktuese në këtë ecuri ishte rënia e eksporteve (-6.8%), kundrejt një pakësimi të lehtë të importeve të mallrave (-0.2%). Aktiviteti tregtar për periudhën tregon për një zvogëlim me rreth 2.4% të flukseve tregtare, krahasuar me të njëjtët muaj të një viti më parë. Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet rezultoi 48.1% ose rreth 3.4 pikë përqindjej më i ulët se ai i një viti më parë.

Grafik 26. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2015, eksporti i mallrave në vlerë u zvogëlua kryesisht nga kontributi negativ i rënies vjetore të eksportit të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" (-40%). Prirja e çmimit të naftës për fuçi në tregun ndërkombëtar[37] ka ndikuar në rënien e vlerës së eksportit të këtij produkti me rreth 67%, në nivel vjetor. Ndërkohë, eksporti i kategorive "Materiale ndërtimi dhe metale" e "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" është rritur me ritme të përshpejtuara gjatë këtyre dy muajve. Kjo ecuri është mbështetur prej sasisë më të lartë të eksportit të mallrave bazë të metalit, si dhe prej rritjes së çmimit të gizës dhe aluminit në tregjet ndërkombëtare. Kontribut tjetër të rëndësishëm pozitiv dha edhe zgjerimi i eksportit të produkteve në kategorinë "Ushqim, pije dhe duhan". Megjithatë, ritmet rritëse të dy muajve të parë të vitit 2015 ishin më të ulëta se ato të regjistruara gjatë vitit 2014. Eksporti i produkteve me material porositësi rezultoi me ngadalësim vjetor gjatë periudhës janar-shkurt. Ngadalësimi i importit të produkteve të ndërmjetme që përdoren në industrinë me material porositës, gjatë fundit të vitit 2014 dhe fillimit të vitit aktual, nuk sugjerojnë përshpejtim të eksportit të produkteve në kategorinë "Tekstile dhe këpucë", gjatë periudhës në vijim[38].

[37] *Çmimi i naftës për fuçi në tregjet ndërkombëtare, gjatë muajve janar-shkurt, ra në terma vjetorë me rreth 51.2% (EIA, prill 2015), ndërsa çmimi mesatar për fuçi për naftën shqiptare ra me rreth 45.6% (INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë).*

[38] *Vlerësimet statistikore sugjerojnë praninë e një korrelacioni pozitiv me një kohë-vonesë (4 muaj), ndërmjet eksportit të mallrave me material porositës, me importin e mallrave të përdorura për prodhimin e tyre (rieksporte).*

Rënia e importit të mallrave në vlerë, gjatë muajve janar e shkurt, u përcaktua kryesisht nga dinamika negative e importit të mallrave të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" (me rreth -35.5%). Brenda kësaj kategorie, ndikimin kryesor e dha importi më i vogël i energjisë elektrike për këto dy muaj. Ndërkohë, ritmi rritës vjetor i importit të mallrave që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin në industritë tekstile me karakter rieksportues është ngadalësuar ndjeshëm (1.4%), krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (25.5%). Nga ana tjetër, kategoria e importeve "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" është zgjeruar me rreth 11.9% në terma vjetorë. Dinamikë të ngjashme ka shfaqur edhe importi i kategorisë "Materiale ndërtimi dhe metale". Ecuria e dy kategorive të mësipërme është e lidhur ngushtë me pritjet pozitive për performancën e investimeve private në vend për tremujorin e parë të vitit.

Aktiviteti eksportues i vendit vijon të jetë i orientuar drejt tregjeve të Italisë, Kosovës, Turqisë, Spanjës, Greqisë dhe Kinës. Ndërkohë, origjina e produkteve të importuara është më e larmishme, ku vendet e BE-së vijuan të mbajnë peshën kryesore ndaj totalit edhe gjatë dy muajve të parë të vitit 2015 (56%).

HAPËSIRË INFORMUESE 3: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2014

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 377.5 milionë eurosh në tremujorin e katërt të vitit 2014, duke ndjekur një prirje zgjeruese për të pestin tremujor radhazi. Për këtë tremujor, deficiti i regjistruar u thellua me rreth 12% në nivel vjetor dhe u vlerësua në nivelin 14.5% ndaj PBB-së nominale. Ndërkohë, për të gjithë vitin 2014, ky deficit u vlerësua në rreth 12.9% ndaj PBB-së nominale, duke u zgjeruar me rreth 25.7% krahasuar me vitin 2013. Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente për tremujorin në analizë, kontribut të kahut zgjerues ka dhënë përkeqësimi i deficiteve të të ardhurave parësore dhe të eksporteve neto. Ndërkohë, suficiti i të ardhurave dytësore u zgjerua me ritme të përshpejtuara në nivel vjetor. Ky i fundit dha ndikim të kahut ngushtues në ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente.

Këtë tremujor, kërkesa e huaj nuk ndihmoi në rikthimin e prirjes rritëse të eksportit të mallrave dhe të shërbimeve. Prirje rënëse shfaqën edhe importet e mallrave dhe shërbimeve, por ritmet e regjistruara ishin më të moderuara krahasuar me ato të eksporteve. Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore qëndroi në territor negativ për të pestin tremujor radhazi dhe thelloi më tej deficitin e regjistruar, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2013. Në anën tjetër, gjatë këtij tremujori është regjistruar një rritje prej rreth 12.9% e të ardhurave dytësore, ku vlen të theksohet rritja vjetore e dërgesave prej emigrantëve me rreth 22.1%.

Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale u rritën në 21.1 milionë euro, nga 18.2 milionë euro që ishin gjatë tremujorit të katërt të vitit të kaluar. Flukset neto në llogarinë financiare u rritën me rreth 26.5% në nivel vjetor dhe financuan 75.7% të deficitit të llogarisë korrente. Investimet e huaja direkte neto u zvogëluan lehtësisht me rreth 0.8% në terma vjetorë. Në anën tjetër, investimet e tjera neto u vlerësuan në zvogëlim të mjeteve të zotëruara jashtë me rreth 122.2 milionë euro, si rrjedhojë e rënies së mjeteve në formë monedhash e depozitash. Megjithatë, këto të fundit janë kompensuar disi nga një rritje me rreth 104.7 milionë euro e mjeteve jashtë në formë investimesh portofoli të zotëruara prej rezidentëve.*

Tabelë 6. Tregues të bilancit të pagesave

	T3 '13	T4 '13	T1 '14	T2 '14	T3 '14	T4 '14
Llogaria korrente (në mil euro)	-191.0	-337.0	-271.5	-341.0	-313.2	-377.5
vmv (%)	-22.9	63.7	21.3	19.5	64.0	12.0
/ PBB-së (%)	-8.2	-13.4	-11.7	-12.8	-12.6	-14.5
Mallra dhe shërbime	-395.4	-518.9	-396.2	-473.3	-462.8	-536.0
Eksporte, f.o.b.	861.3	808.7	608.8	752.0	838.8	757.1
Importe, f.o.b.	1256.8	1327.6	1005.0	1225.3	1301.6	1293.1
Udhëtime neto	26.1	34.0	-21.8	10.6	32.0	66.0
Të ardhura parësore	22.2	0.0	-20.6	-43.3	-48.7	-47.0
Kredi	40.2	33.4	28.7	25.7	28.3	27.8
Debi	18.0	33.4	49.3	69.1	77.0	74.8
Të ardhura nga IHD-neto	6.2	6.9	-30.4	-47.1	-56.2	-38.6
Të ardhura dytësore	182.3	181.9	145.3	175.6	198.3	205.4
Kredi	216.5	213.5	172.6	204.4	230.6	244.1
Debi	34.2	31.6	27.3	28.8	32.3	38.8
Dërgesa nga emigrantët -neto	152.5	140.1	118.2	137.5	165.1	171.0
vmv (%)	8.3	-28.6	-2.8	6.1	8.3	22.1
/PBB	6.5	5.6	5.1	5.1	6.6	6.5
Llogaria Kapitale	15.0	18.2	22.5	22.4	20.7	21.1
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-175.9	-318.8	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4
Llogaria financiare	-70.9	-226.1	-199.1	-214.5	-206.1	-285.9
vmv (%)	78.4	-16.2	57.2	-18.3	190.7	26.5
/ PBB-së (%)	-3.0	-9.0	-8.6	-8.0	-8.3	-10.9
Investime direkte	-307.0	-231.2	-168.0	-150.4	-253.4	-229.4
vmv (%)	145.2	22.2	46.7	-44.4	-17.4	-0.8
Investime portofoli	6.2	-18.1	14.5	14.0	-12.4	104.7
Derivativë financiarë	0.0	-2.4	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	195.4	18.6	-5.2	-100.6	-94.2	-122.2
Mjetet e rezervës	34.5	7.1	-40.3	22.5	154.0	-38.9
Financimi i deficitit korrent (Ll. Financiare)	37.1	67.1	73.3	62.9	65.8	75.7
Gabime dhe harresa	105.1	92.7	49.9	104.2	86.4	70.5
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-175.9	-318.8	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zvogëlim të mjeteve të rezervës valutore me 38.9 milionë euro. Në fund të muajit dhjetor, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.19 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin me 5.5 muaj import të mallrave dhe të shërbimeve dhe për mbulimin e 181% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

* *Vlerësimi i investimeve të huaja direkte me frekuencë tremujore gjatë vitit, mbështetet mbi të dhënat që merren nga bankat dhe nuk përfshin informacionin mbi huamarrjen/huadhënien në marrëdhënien e investimit të huaj direkt në Shqipëri. Ky informacion merret vetëm përmes vrojtimit vjetor të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) pranë ndërmarrjeve, i cili publikohet në muajin shtator të vitit pasardhës. Si rezultat i të dhënave që merren nga ky vrojtim, kryhet rishikimi i vlerave të IHD-ve për secilin tremujor. Kështu, vlerat e IHD-ve për secilin tremujor të vitit 2014 do të rishikohen pas vrojtimit të IHD-ve për vitin 2014.*

3.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË, PAGAT, KOSTOT E PUNËS DHE PRIRJET E INFLACIONIT

Presionet inflacioniste nga sektori real i ekonomisë kanë mbetur të dobëta, duke mbajtur inflacionin nën objektivin e Bankës së Shqipërisë edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Rënia e treguesit të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe norma ende e lartë e papunësisë, tregojnë për burimeve të pashfrytëzuara të kapitalit dhe të punës në ekonomi, duke përçuar presione të dobëta për rritjen e pagave dhe të kostove të prodhimit.

Ekonomia shqiptare vijoi të karakterizohet nga prania e një hendeku negativ prodhimi, pavarësisht rritjes më të lartë të saj në vitin 2014. Treguesit e tregut të punës janë në përputhje me këtë vlerësim. Norma e papunësisë u rrit në nivelin 18% në fund të vitit 2014 dhe të dhënat e vrojtimeve tregojnë rënie të shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të bizneseve për tremujorin e parë të vitit 2015.

Grafik 27. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe hendeku i prodhimit (majtas); norma e papunësisë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Vlerësimet dhe parashikimet tona sugjerojnë se përtëritja graduale e kërkesës së brendshme do të rrisë shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, duke ngushtuar hendekun negativ të prodhimit gjatë vitit aktual, drejt mbylljes së tij në vitin e ardhshëm. Në përputhje me kohëvonesat e përcjelljes së impulseve nga ekonomia reale në formimin e çmimeve, presionet inflacioniste pritet të rriten gradualisht për të kthyer inflacionin në objektiv, në një periudhë afatmesme.

Pagat, produktiviteti dhe kostot e punës e të prodhimit[39]

Treguesi përafrues i pagës mesatare regjistroi rënie vjetore në tremujorin e katërt të vitit 2014. Në terma nominalë dhe realë, kjo rënie shënoi përkatësisht vlerat 4.6% dhe 5.8%.[40] Nga ana tjetër, rritja e lehtë tremujore e treguesit të rregulluar për sezonalitet mund të sinjalizojë ndërprerje të tendencës rënëse të shfaqur në paga. Gjithashtu, të dhënat e vrojtimeve të besimit sinjalizojnë zhvillime më pozitive të ecurisë së pagave në tremujorin e parë të vitit 2015.

Grafik 28. Ecuria e pagës mesatare reale në ekonomi dhe në sektorë



Burim: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, treguesi i produktivitetit të punës (PP) në aktivitetin jobujqësor shënoi një dinamikë më negative (-9.5%) se ajo e pagës mesatare reale, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014. Për pasojë, treguesi i kostove të punës për njësi (KPNj) rezultoi me ngadalësim të rritjes vjetore (5.2%). Në të njëjtin tremujor, edhe ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit industrial (IÇP) regjistroi thellim gradual të ritmeve negative (-0.4%).

[39] *Treguesi i pagës mesatare, ai i produktivitetit të punës dhe i kostove të punës për njësi të prodhuar, llogariten nga Banka e Shqipërisë, nga seritë e Statistikave Afatshkurtra të T4'2014 (SASH, INSTAT). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indeksi i punësimit, i xhiros dhe i fondit të pagave, për aktivitetin jobujqësor. Treguesi i pagës mesatare llogaritet si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve (duke përjashtuar sektorin bujqësor dhe të vetëpunësuarit me pagesë). Në terma realë, indeksi i pagës mesatare deflatohet me IÇK.*

[40] *Nga tremujori i parë i vitit 2014, statistikat ku mbështetet llogaritja e këtij treguesi pësuan ndryshime metodologjike. Në këto ndryshime përfshihen: zbatimi i nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike NVE Rev.2, përditësimi i peshave të përfaqësimit sipas metodës chain link dhe përditësimi i periudhës referuese. Më 27 qershor 2014, INSTAT-i njoftoi zbatimin e NVE Rev. 2 për raportimet e veprimtarive ekonomike, si pjesë e statistikave të aktivitetit të bizneseve. Kalimi nga NVE Rev 1.1 në NVE Rev 2 është në kuadër të detyrimeve që INSTAT-i ka kundrejt EUROSTAT-it, për të siguruar përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato evropiane. Zbatimi i NVE Rev. 2 është bërë me aktin ligjor të miratuar me VKM nr. 320, në datën 28.05.2014.*

Grafik 29. Ndryshimet vjetore mesatare të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit*



*Për të treguar prirjet e treguesve, ndryshimet vjetore të tyre janë sheshuar me mesataret lëvizëse me 4 terma.
Burimi: INSTAT dhe llogaritje të BSh.

Ecuria e treguesve të mësipërm tregon praninë e presioneve inflacioniste të dobëta nga krahu i pagave dhe i kostove prodhuese në sektorët jobujqësorë të ekonomisë.

Prirjet kryesore të inflacionit

Në tremujorin e parë të vitit 2015, inflacioni bazë dhe ai i sektorit të patregtueshëm të IÇK-së rezultuan përkatësisht 0.5% dhe 2.1%,[41] lehtësisht më të larta sesa ato të tremujorit të kaluar. Duke përfaqësuar prirjet afatgjata dhe me origjinë të brendshme të inflacionit, ecuria e këtyre treguesve pasqyroi një rritje të presioneve inflacioniste nga ana e kërkesës. Inflacioni bazë kontribuoi me 0.33 pikë përqindje (apo 17.5%) në formimin e inflacionit total. Për rrjedhojë, ecuria e inflacionit total përgjatë tremujorit në analizë, u përcaktua më së shumti nga rritjet e përbërësve afatshkurtër. Inflacioni vjetor jobazë dhe ai i tregtueshëm rezultuan përkatësisht 5.2% dhe 2.2%.

Grafik 30. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas).



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Vlerësimet e mësipërme, tregojnë se presionet inflacioniste afatgjata po vijnë në rritje. Megjithatë, në përputhje me pritjet tona, kjo rritje do të jetë graduale, me kthim të qëndrueshëm të inflacionit në objektiv, në afat të mesëm.

41 *Inflacioni bazë rezulton si mesatare e thjeshtë e dy matjeve: me përjashtim të përhershëm të të njëjtëve artikuj të shportës; me mesatare të reduktuar me 30% të artikujve, simetrikisht në dy skajet e shpërndarjes së kontributeve mujore të inflacioneve të grupeve dhe nëngrupeve kryesore të shportës së IÇK-së. Inflacioni i patregtueshëm, i referohet ndryshimit në IÇK-në e një nënshporte që përbëhet kryesisht nga shërbime, por edhe mallra të caktuara të saj.*

3.4 ÇMIMET E HUAJA DHE INFLACIONI I IMPORTUAR

Presionet e huaja inflacioniste gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, kanë rezultuar në rritje. Indeksi "Çmime të huaja"[42] shënoi një rritje vjetore 4.2%. Kjo ecuri u përcaktua nga inflacioni dyshifror i Turqisë dhe i Rusisë, kundrejt presioneve deflacioniste të gjeneruara nga vendet partnere kryesore evropiane. Nënçmimi vjetor i monedhës vendase në termat e NEER (rreth 3%), veçanërisht në muajin mars, shtoi praninë e presioneve të huaja inflacioniste në vend. Si rezultat i zhvillimeve të mësipërme, indeksi TPHI[43] u rrit në terma vjetorë me 7.3%, duke qëndruar 3.4 pikë përqindje më lart se në tremujorin e kaluar.

Grafik 31. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas)
Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Inflacioni i importuar kontribuoi pozitivisht në formimin e inflacionit total. Kontributi vjetor i inflacionit të importuar u vlerësua rreth në 1.08 pikë përqindje (apo 56%) të inflacionit total. Ky kontribut pasqyroi luhatjet në çmimet e ushqimeve dhe të mallrave bazë në tregun ndërkombëtar dhe vendas, të shoqëruara nga dobësimi i lekut kundrejt dollarit amerikan. Pjesa e mbetur e inflacionit u formua nga inflacioni i brendshëm.

[42] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së vendase. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat: e inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; dhe inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm "Ushqime") për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë. Disa nga mallrat kanë shënuar rritje vjetore të çmimeve, ndërsa janë rritur edhe peshat e importeve me shtetet përkatëse. Kjo ka ndikuar që vlera përfundimtare e treguesit (mesatare e ponderuar e IÇK-ve të lartpërmendura me peshat mujore të importit të tyre), të shënojë një rritje jo pak të rëndësishme.*

[43] *TPHI llogaritet si rritja vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit NEER për muajin përkatës. Presionet inflacioniste me origjinë të huaj vlerësohet që ndikojnë inflacionin me 1-3 muaj vonesë.*

3.5 PRITJET PËR INFLACIONIN[44]

Grafik 32. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pritjet inflacioniste të matura nga vrojtimet pranë agjentëve të ekonomisë, vijuan në përgjithësi prirjen rënëse në tremujorin e parë të vitit 2015. Aktualisht, ato qëndrojnë në vlera poshtë objektivit për inflacionit. Pritjet afatmesme, qëndrojnë më pranë vlerës 3%[45]. Në tremujorin e parë, konsumatorët rishikuan për poshtë me 0.4 pikë përqindje pritjet e tyre (pas rritjes me 0.5 pikë përqindje në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014), pritjet e agjentëve financiarë ranë me 0.1 pikë përqindjeje, ndërsa pritjet e bizneseve regjistruan një rritje të lehtë me 0.1 pikë përqindje[46].

.

[44] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezultatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, me frekuencë tremujore, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë, me frekuencë mujore.*

[45] *Bazuar në të dhënat mujore nga vrojtimi i pritjeve të agjentëve financiarë.*

[46] *Pritjet e bizneseve dhe të konsumatorëve maten nga vrojtimet e besimit.*

4. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË

Tregjet financiare u karakterizuan nga një likuiditet i lartë, norma të ulëta interesi dhe një dobësim i kursit të këmbimit gjatë muajve të parë të vitit 2015. Zgjerimi i masës monetare rezultoi në nivele të ngjashme me ato të fundit të vitit 2014. Ky zgjerim u mbështet nga komponenti valutor, si dhe nga financimi i sektorit publik. Kërkesa e lartë nga sektori publik është materializuar në rritje të lehtë të yield-eve në tregun e letrave me vlerë. Sektori privat ka dhënë një kontribut më të ulët në zgjerimin monetar, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2014.

Kostot e financimit mbeten të ulëta dhe favorizuese për rigjallërimin e kredisë. Megjithatë, kërkesa e sektorit privat për financim vijon të mbetet e dobët. Paralelisht me këtë dhe oferta e bankave për financim mbetet e shtrënguar, ndonëse cilësia e portofolit është në përmirësim. Nga ana tjetër, normat e ulëta të interesit të depozitave kanë nxitur konsumatorët drejt zhvendosjes së kursimeve në segmente të tregut financiar me norma më të larta kthimi.

4.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Tregu ndërbankar

Normat e interesit në tregun ndërbankar janë karakterizuar nga ecuri rënëse gjatë tre muajve të parë të vitit 2015. Ky zhvillim është favorizuar nga gjendja e mirë e likuiditetit dhe nga kahu lehtësues i politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione të rregullta në treg të hapur për injektimin e likuiditetit, me instrumentin kryesor (marrëveshjen e anasjellë të riblerjes me afat 7-ditor) dhe me marrëveshje të anasjellë riblerjeje me maturim 1-mujor. Likuiditeti i injektuar në sistem ka qenë më i vogël se tremujorin e kaluar dhe norma e interesit e rezultuar në këto ankande ka qenë vazhdimisht afër normës bazë.

Ulja e normës bazë të interesit në fund të muajit janar 2015, është reflektuar menjëherë në tregun ndërbankar. Normat ditore të interesit kanë lëvizur kryesisht poshtë normës bazë[47] dhe treguesit e luhatshmërisë për tremujorin tregojnë për një ecuri të qëndrueshme të tyre[48]. Norma mesatare e interesave njëditore në tremujorin e parë rezultoi 2.02% ose 0.36 pikë përqindjeje më poshtë nga ajo e tremujorit të mëparshëm, ndërsa ajo 7-ditore zbriti në 2.05%, nga 2.40% tre muaj më parë.

[47] *Diferenca e normës së interesit ditor me normën bazë ishte 9 pikë bazë në këtë tremujor nga 6 pikë bazë një tremujor më parë.*

[48] *Devijimi standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për tremujorin e parë rezultoi 0.194, nga 0.174 që ishte në tremujorin paraardhës.*

Grafik 33. Operacionet e tregut të hapur të BSH (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithëse volumi i tregtuar pësoi tkurrje të lehtë gjatë kësaj periudhe, ai nuk qëndroi larg mesatareve të tremujorëve të fundit. Profili i transaksioneve ka vijuar të jetë në favor të shkëmbimeve javore. Transaksionet javore dhe ditore shënuan respektivisht 6.3 dhe 2.2 miliardë lekë nga 6.8 dhe 1.9 miliardë që shënonte një tremujor më parë.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar

Si për instrumentet afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjata, *yield*-et shfaqën një prirje të lehtë rritëse gjatë tremujorit të parë. Vlerat e *yield*-eve në këtë tremujor kanë qenë përgjithësisht më të larta se vlerat e tyre në fund të tremujorit të kaluar, duke mos pasqyruar uljen e normës bazë të interesit të muajit janar. Rritja e kërkesës së qeverisë për financim dhe oferta më e shtrënguar e sistemit bankar, ka ushtruar presione rritëse mbi *yield*-et. Megjithatë, në fund të periudhës kjo prirje ndryshoi kah.

Grafik 34. Ecuria e *yield*-eve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesëmarrja në ankandet e shpallura për instrumentet afatshkurtra dhe afatgjata ka qenë e lartë, duke pasur edhe ankande të mbikërkuara.

Vlera e *yield*-it 12-mujor shënoi 3.57% në fund të muajit mars, nga 3.45% në fund të dhjetorit. *Yield*-et e afateve 3- dhe 6-mujore shënuan përkatësisht 3.06% dhe 3.23%, nga 3.22% dhe 3.16% që ishin në fund të vitit. Agjentët e tregut kanë shfaqur pak interes për obligacionet e tjera me normë të ndryshueshme, duke mos ushtruar presione për uljen e marzheve të tyre.

Fundi i tremujorit dhe fillimi i muajit prill shënuan kthimin e pririjes rënëse të *yield*-eve për të gjitha maturitetet. Zhvendosja e kërkesës së qeverisë nga financim i brendshëm në të jashtëm pritet të ushtrojë presione rënëse mbi *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë. Në datën 10 prill, agjencia ndërkombëtare e rating-ut Standard & Poor's konfirmoi vlerësimin në nivelin B/B me pritje pozitive për cilësinë e borxhit publik shqiptar.

Kursi i këmbimit

Monedha vendase është karakterizuar nga presione nënçmuese në rritje, nën ndikimin e faktorëve kryesisht të jashtëm, në tremujorin e parë të vitit 2015. Indeksi NEER[49], tregoi për një nënçmim të lekut me 3.0% në terma vjetorë, vlera më e lartë që prej muajit nëntor 2010. Ndërkohë, në raport me tremujorin e kaluar, nënçmimi rezultoi në masën 1.8%. Kontributin më të madh në këtë ecuri e dha forcimi i vazhdueshëm i dollarit amerikan në tregjet financiare. Si rrjedhojë e mungesës së presioneve inflacioniste në vendet partnere tregtare të Eurozonës dhe rritjes së inflacionit vjetor në vend, leku në terma realë u nënçmua me vetëm 1.6% në bazë vjetore. Paralelisht me zhvillimet e lartpërmendura,

Grafik 35. Ndryshimet vjetore të indeksit NEER, indeksi i presioneve në tregun valutor (IPV) dhe kursi bilateral i këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[49] *NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë, të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina. Një rritje e NEER do të thotë nënçmim i lekut.*

indeksi i presioneve në tregun valutor[50] rezultoi në rritje, ndonëse ka vazhduar të qëndrojë poshtë mesatares së tij historike.

Kursi mesatar i këmbimit euro/lek rezultoi 140.2 lekë në tremujorin e parë, duke nënkuptuar një mbiçmim me 0.1% në terma vjetorë dhe një nënçmim me 0.4% në terma tremujorë. Gjatë këtij tremujori, kursi euro/lek është luhatur në një interval të ngushtë prej 139.6-140.6 lekësh, duke u tregtuar në nivele më larta në muajt shkurt-mars. Pikërisht në këtë periudhë, kërkesa për valutë është shfaqur në rritje, nxitur si nga agjentët publikë ashtu edhe nga ata privatë të tregut. Përballë kësaj dinamike, oferta për valutë është shfaqur më e dobët.

